

ALBANIAN POST

**Nr.
59**

**KORRIK /
JULY
2023**


Editor in Chief: Dr. Fatmir Terziu - Telephone: 07984497444 - contact@fjalaelire.com - www.fjalaelire.com




04 Suedi...



07 Demokracia...



10 Elbasani...



19 Vlora...

NGJYROSJA E FUNDIT

Shqipëria e ringjyrosur purpull pas zgjedhjeve të fundit elektorale është një ferr i tmerrshëm, selfist, arrogant, apo jo? Në fund të fundit, ky ka qenë mesazhi i shpërndarë nga elitat kulturore dhe politike purpull për pjesën më të mirë të dhjetë viteve pushtet. Shqipëria në këto vite, e sidomos pas zgjedhjeve të fundit lokale ka pasur op-editoriale të përgjithshme që i referohen pafundësisht "një vale të keqe" arrogantizmi, që supozohet se ka nisur nga votimi masiv për PS-në. Kemi pasur shkrime të mediave të ndryshme që sjellin vizione të ndryshme të një Shqipërie të konsumuar nga urrejtja politike, dhe të sfumuar, ose të lënë mënjanë nga vëmendja e...

(vijon në faqen 02)

RESTORANTI I MUNGUAR
SHQIPTAR NË LONDËR

Flora Kolaveri Osmani

DIRETTORE GUSTO 272
ITALIAN



TEL. 02089047775

EMAIL:

INFO@GUSTOITALIAN.CO.UK

Rezervoni dhe do të na kujtoni

I HAPUR:

DAŠMA-FESTA-FAMILJARE-
DITELINDJE- OKAZIONE TË TJERA



24/7 orë linjë emergjence
07878335000

**Këshilla
Ligjore
FALAS**



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths



solicitors@rashidandrashid.co.uk
Tel: 02085401666



Adresa: 190 Merton high street,
Wimbledon, London, SW19 1AX

Ekspert

**DETENTION
DEPORTATION
PRISON**



(vijon nga faqja 01)

.. të huajve. Dhe ne kemi pasur politikanë dhe të famshëm në arrogancën e tyre të panumërt që pretendojnë se nuk e njohin më këtë komb të shkëputur nga udha e tij demokratike me një start opozitar të munguar në dyzetë vite diktaturë, por të cunguar e gjithnjë në vite tranzicioni të ndarë dhe së fundi me një mendësi e një qasje tipike mendjevogël.

Dhe Shqipëria në këtë këndvështrim është bërë shoshë komentesh dhe debatesh për emigracionin edhe në Britaninë e Madhe. Vetëm shifrat e migracionit të javës së kaluar nga Zyra për Statistikat Kombëtare të Britanisë së Madhe dhe reagimi publik ndaj këtyre shifrave tregojnë një histori shumë të ndryshme për situatën që detyron Britaninë, jo vetëm të debatit për emigracionin dhe Brexit-in, por dhe për fenomenin e shqiptarëve që mësyjnë me të gjithë format, ku thuhet se numri i shqiptarëve të ardhur në këtë vend duket absurd dhe i patolerueshëm.

Siç u raportua nga ONS të enjten e kaluar, migrimi neto vitin e kaluar ishte në një rekord dhe flitej gjithnjë e më shumë me theks në këtë pikë. Pra, që kur Mbretëria e Bashkuar u largua nga Bashkimi Evropian në vitin 2020, Britania e Madhe ka mirëpritur në një numër të paprecedentë migrantësh nga e gjithë bota, veçanërisht nga vende si India, Nigeria dhe Shqipëria. E këtua natyrisht hyn dhe diplomacia. Herë pas here është kundërshtuar dhe mbrojtur e drejta e migrimit dhe shqiptarëve u kanë dalë në kah ambasadorë dhe shefa, madje dhe vetë Kryeministri Rama, por ajo që shkon më tej është vetëm zë, dhe fundja asgjë. Kush i bënë të ikin shqiptarët?! Ambasadorët shkojnë e vijnë. E në këtë pikë zërrat gumëzhijnë. Një listë e madhe emrash të rinj flitet të zënë postet diplomatike anemabanë ku Shqipëria ka marrëdhënie të tilla. Në një debat e sipër deputeti Alizoti e ka ngritur zërin dhe është shprehur se "Ambasadori është një figurë e madhe, serioze e

një shteti. Ndaj mendoj se nuk duhet të jetë vend qokash. Ka dhe një trupë diplomatike, që kanë vite. Diplomacia ngjan me ushtrinë dhe ka radhë. Politika e jashtme është diçka kombëtare, nuk i përket një partie, por të gjithë shqiptarëve. Duhet të ketë në politikën e jashtme edhe njerëz që nuk e duan kryeministrin, por që mendojnë edhe ndryshe nga ai. Njerëzit shumë të ditur janë dhe rebelë." E në këtë pikë deputeti Gjekmarkaj thotë se "Kur bëjmë diplomaci, bëjmë folklor". E kjo ndodh sigurisht pas votimit të fundit. Jo se nuk ka ndodhur më parë, por këtë herë vetë drejtuesja e Komisionit të Punëve të Jashtme e bën më të qartë kur ndërhyr dhe i bën urdhër të prerë kandidatës për deputete në Izrael që të mos përgjigjet. Pra të heshtë, kur deputeti Shehu e pyet. E gjitha ka një sqarim të plotë, jo thjesht tek arroganca, apo tek emërimet, por tek ajo që aty nuk dëgjohet dhe nuk duhet të dihet.

Nëse gërmoni pak më thellë në statistikën e votimit jashtë këtij debati, shfaqet një pamje e nuancuar. Është e vërtetë që shumica e njerëzve, kur pyeten, do të thonë se mosbesimi tek kjo politikë në përgjithësi është 'shumë i lartë'. Por shumica e njerëzve ende mbështesin llojet specifike të interesit që përbëjnë pjesën më të madhe të flukseve të punësimeve, premtimeve dhe emërimeve në administratën lokale e më tej. Merrni tre burimet kryesore të rritjes së prepotencës dhe arrogancës politike pas zgjedhjeve. Së pari, ekziston dyshimi se dikush ka forcë të kundërshtojë. Nuk ka aspak opozitë. Dhe ajo që ekziston dihet si trajtohet. Ka një mëdyshje të mjaftueshme publike për skemat e tilla si ajo e të arrestuarve nga SPAK për korrupsion, dhe si ky i fundit i Vangjush Dakos, të cilat kanë çuar në dilemë. Dilema ishte dhe jetoi mediave dhe vetëm atje, pra në faqet e ekranet e medias, gjatë vitit të kaluar. Ekziston gjithashtu një trajtesë e nënzhësme e disa rekrutimeve politike.



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths



HIGH COURT OF JUSTICE:

NËSE NDONJË/RA ËSHTË VIKTIMË:

1. E TRAFIKIMIT NJERËZOR
2. E SKLLAVËRISË MODERNE

KA TË DREJTË PËR LEJE QËNDRIMI



Mendo për ëndrrën tënde,
mos u ndal!

Ne jemi këtu për Ju.
www.fjalaelire.com



Reklamo tek revista
"Albanian Post"



GUSTO 272 ITALIAN

RESTORANTI I MUNGUAR NË LONDËR



ZBULO NIVELIN E RI TË SHIJES
Dasma-Festa-Ditëlindje-Familjare-Komunitet



**ADRESA: VETËM DY MINUTA LARG NGA
STACIONI I TRENIT PRESTON ROAD**



TELEFON: 020 8904 7775
EMAIL: INFO@GUSTOITALIAN.CO.UK



URA E UDDEVALLAS QË BASHKOI KRIJUESIT

Ndërsa në Uddevalla të Suedisë zhvillohej Festivali i Parë Ndërkombëtar i Poezisë “Ura” në një revistë të marë e vete në udhëtimin nga Borås drejt këtij qyteti në makinën familjare të dy anëtarëve të shoqatës “Migjeni” autorë librash, Aleksandër dhe Anxhela Ziso, lexoja mendimin e të mirënjohurit të medias dhe ekanit dhe më së shumti të emisionit britanik “University challenge”, Jeremy Paxman që në thelb shkruante se “poezia duhet të jetë më tërheqëse rreth fuqisë së formës së artit.” Ishte e hëna e 5 qershorit që në Göteborg kishte lënë një ditë më parë trokthet e kuajve mbretërorë të Suedisë që përgatiteshin për festën Kombëtare e në skaj të urës së madhe do të shikoje tërë atë grumbullim qytetar për këtë festë që shijohej me pije e ushqime rruge. Por syri në këtë rast luante vetëm rolin e bllokut të shënimeve e mendja udhëtonte enkas në bibliotekën Rampen në qytetin Uddevalla të Suedisë, ku u mbajt Festivali i Parë Ndërkombëtar i Poezisë “Ura” me poetë pjesëmarrës nga Shqipëria, Kosova, Anglia, Zvicra dhe poetë lokal nga Udevalla, Göteborgu e nga qytei Borås, që interpretuan poezi të tyre në shqip, suedisht, anglisht, dari, arabisht e bullgarisht...

Themeluesi dhe nikoqiri i festivalit poeti Rizah Sheqiri natyrisht ishte i pari që na dhuroi mirëpritjen atë ditë dhe në ambientet e bibliotekës në fjalë natyrshëm ndihej festivja dhe emocionalja. Kjo nuk zgjati shumë pasi në mjedisin tip tetri të kësaj biblioteke, që funksionon edhe si një mjedis shkollor, rinor e më gjerë zunë vend të ftuarit. Kështu hapja e Festivalit të Parë Internacional të Poezisë e të Letërsisë u bë

nga poeti e shkrimtari Rizah Sheqiri, që sikurse e cituam ishte dhe themelues dhe nikoqiri i festivalit “Ura”, pra aty në amfiteatrin e Bibliotekës Rampen të Uddevallës.

Fjala hyrëse shqip e suedisht nga Rizah Sheqiri dukej se tingëllonte bukur edhe në gjuhët e tjera. Sakaq e përcjellim në origjinalin e saj dhe po aq edhe në gjuhën e bukur shqipe: “Ordet det vackra och fria, det skrivna ordet är den bästa bron mellan språk, kulturer och människor. Detta är syftet av festivalen “Ura” - Bron som vill få språk, kulturer och människor att komma närmare varandra. Vi startar den här internationella poesifestivalen för att grunda en fast bro av ord i syfte om att bli traditionell.” (Fjala e bukur dhe e lirë, fjala e shkruar është ura më e mirë ndërmjet gjuhëve, kulturave dhe njerëzve. Ky është qëllimi i festivalit “Ura” (Bron) – Ura që dëshiron të afrojë gjuhët, kulturat dhe njerëzit. Po e nisim këtë festival ndërkombëtar të poezisë për të krijuar një urë solide fjalësh me synimin për t’u bërë tradicional) (Rizah Sheqiri)

Pas hapjes zyrtare Festivali në mënyrë simbolike nisi me poezinë e Rizah Sheqirit “E di fëmija ç’është Liria” të cilën e recitoi nxënësja e klasës së pestë loona Jorgollari, e cila poashtu e lexoi një nga poezitë e saj, që ngjalli mjaft emocionet në atë amfiteatër të bukur të prindërve të saj poetes dhe publicistes së mrekullueshme Gladiola Jorbus dhe babait të saj të dedikuar Arjanit, po ashtu dhe të gjithë sallës. Kështu Festivali dukej se kishte filluar të ndërtojë urën simbolike. E në këtë pikë doli në skenë libri studimor “Influenca diskursive



të krijimtarisë shqiptare në Suedi”, me të cilin vitet e përgatitjes dhe realizimit në botim tashmë shihnin dritaren e madhe dhe urën e këtij Festivali që ndërlidhte kulturat, pasi dhe vetë studimi kishte këtë pikë.

Pra Festivali nisi punën me pjesën kryesore ku u bë prezentimi i studimit “Influenca diskursive të krijimtarisë shqiptare në Suedi” të Fatmir Terziut në shqip e anglisht. Për këtë dhuratë nga më të çmuarat, sipas R. Sheqirit, që iu bë këtij festivali dhe gjithë komunitetit shqiptarë, veçanërisht krijimtarisë së krijuesve në Suedi, në emër të festivalit, në emër të gjithë krijuesve letrar në Suedi e më gjërë, në emër të Shtëpisë Botuese R, të cilën e drejton ai, si dhe në cilësinë e themeluesit dhe drejtuesit të Festivalit të Parë Internacional të Poezisë “Ura” dhe në emrin e tij personal falenderoi shkrimtari dhe poeti Rizah Sheqiri, i cili ndër të tjera u shpreh: “... Ky studim letrar i pari i këtij lloji për shkrimtarët e Suedisë dhe më gjërë, është i një rëndësie tepër të veçantë. Një studim i bërë me kompetencë shkencore nga një studiues i mirëfilltë Prof. Dr Fatmir Terziu, i cili është nga të parët studiues që në mënyrë kaq serioze bën këtë studim të këtij lloji krejt të veçantë të për trajtimin e vlerave letrare që

sjellë letërsia që krijohet në diasporë, konkretisht në Suedi. Prandaj studimin dhe botimin e tij unë personalisht e vlerësoj si një nga ngjarjet e rëndsisë së veçantë kulturore e historike. Prezentimi i këtij studimi në festivalin e dymbëdhjetë “Sofra poetike” në Borås më 3 qershor dhe më 5 qershor në Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë “Ura” në Uddevalla, në vigjilje të 500 vjetorit të themelimit të Suedisë dhe për nder të ditës kombëtare të Suedisë 6 qershorit, merrë edhe një dimension tjetër të një rëndësie të veçantë dhe vjen si një mirënjohje, nga më të lartat, ndaj vlerave njerëzore kulturore e letrare që krijohen në Suedi, qoftë nga vendasit qoftë edhe nga krijuesit shqiptarë që veprojnë e krijojnë këtu. Prezentimi i këtij studimi të veçantë në këto rrethana i jep edhe më shumë kuptimësi gjithë aktivitetit letrar e kulturor të këtyre ditëve dhe e nderon në mënyrën më të mirë komunitetin shqiptarë dhe miqet e tij suedez duke e pasqyruar denjësisht e me shumë kompetencë prej studiuesi gjithë vlerat, angazhimin e intelektualëve shqiptarë, krijuesve letrar e artistik, qoftë si individ qoftë si komunitet, edhe në raport me vlerat që krijohen në atdhe dhe me ato vlera që krijohen, vlerësohen e lartësohen në Suedi...



RASHID & RASHID
Solicitors, Advocates
Immigration Specialists
Commissioners of Oaths



Këshilla ligjore FALAS

Specialist i azilit të
trafikimit njerëzor

- Dokumente udhëtimi
- Procedura për leje qëndrimi dhe viza
- Kur jeni kotigjent për t'u riatdhesuar ose të ndaluar nga organet e emigracionit
- Mbulojmë të gjitha aspektet e emigracionit
- Zgjatje vizash
- Leje pune
- Rishikim juridik
- Apelimi Tribunali
- Rastet e trashëgimisë

24/7 orë linjë emergjence
07878335000

Rashid & Rashid Solicitors, si të gjithë avokatët e tjerë në praktikë në Angli dhe Uells, është Kompani e autorizuar dhe e rregulluar nga Autoriteti i Rregullimit të Aplikantëve.


Avokatët tanë të emigracionit kanë mbi dhjetë vjet përvojë në fushën e emigracionit dhe ligjit të azilit.

RASHID & RASHID LAW FIRM
190 Merton High Street,
Wimbledon, London, SW19 1AX
solicitors@rashidandrashid.co.uk
Tel: 02085401666



VILA "RONEL" BAR RESTAURANT

SHIJO NIVELIN E RI TË KUALITETIT



46 BIRCHINGTON ROAD
NW6 4LJ

KONTAKTO: 020 7624 1385



DEMOKRACIA ËSHTË SHUMË MË E MADHE SE BERISHA

Sulmi ndaj Sali Berishës nuk do t'i japë fund telasheve të institucionit të Demokracisë brenda PD-së.

Dy gjëra që duhen mbajtur qartë në mendje, mes kakofonisë së zhurmës që rrethon situatën Sali Berisha. Së pari, pavarësisht nga gabimet e shumta personale të Sali Berishës, ato nuk kishin të bënin pak me rënien e tij, me shpalljen non-grada të tij. Sulmet ndaj Berishës, si kryeministër demokrat me "Fajin e ka Saliu" dhe tani si "non-grada", ishin mbi të gjitha një grusht shteti politik, një akt i hidhur hakmarrjeje të të rrëzuarve prej Demokracisë ndaj njeriut që establishmenti i sotëm allashqiptar e fajëson për Tranzicionin në të cilin dhimbshëm dhe plotë gabime kalon Demokracia shqiptare.

Por së dyti, pozitarët dhe opozitarët që kërkojnë fundin e karrierës politike të Sali Berishës, po mashtrojnë veten nëse mendojnë se kjo do të thotë gjithashtu fundi i problemeve të tyre politike. Sepse, ndërsa kryqëzata anti-Berisha kishte të bënte me shembjen e Diktaturës, por në qasje vitesh dhe me Tranzicionin e dhimbshëm allashqiptar, të praktikuar askund më parë, revolta popullore e shembjes së Komunizmit ishte gjithmonë shumë më tepër se Berisha.

Shumica e politikanëve dhe ekspertëve në qasjet mediatike, televizive dhe në grupe politike (madje edhe duke përfshirë disa zëra më parë simpatikë) kanë hedhur poshtë pretendimet e Berishës se ai është viktimë e një gjuetie shtrigash, e një problemi më të gjerë, sikurse është shprehur ai, e një situatë hakmarrëse në mjaft pika që tashmë dihen, apo dhe për faktorë

të tjerë. Ata thonë se sjellja e tij në vitet e qeverisjes dhe politika e zhveshur në tërësinë e rrugëtimit tranzicion janë fajtorë për situatën ndaj tij, janë pika që i sillen argumenteve për situatën e Opozitës, vetë PD-së, dhe tani nga ndarja e demokratëve në dy kampe.

Askush nuk mund të pretendonte se Berisha i çuditshëm ishte një kryeministër model, ose një Njeri me pektun e politikanit të pagabueshëm. Por nocioni se Berisha është 'armiku më i keq i demokracisë' më tepër e injoron ushtrinë e armiqve të hidhur që janë rreshtuar për të shfrytëzuar situatën si një justifikim për ta mbrojtur atë, fillimisht nga tërë ata që janë me pakënaqësitë e këtyre viteve në thesin e urrejtjes, dhe tërë ata që duan me të gjitha mënyrat të kapin një palë shkallë në ngjitjen e aspektit të zyrës, apo dhe të mbajnë kolltuqet me frymën se ai është e gjithë e keqja.

Elitat e mbetura e urrejnë Berishën jo për shkak të

cilësive të tij personale, ose mungesës së tyre, por sepse e shohin atë si simbolin politik të forcës, së cilës ata vërtet i frikësohen dhe urrejnë: masën e gjerë mbështetëse ndaj tij që nisi me ringritjen e PD-së nga Foltorja dhe që votojnë për të lënë njëherë e mirë këtë sistem ogursi që po mban në kthetrat e tij skenarë të dukshëm e të padukshëm. Si në ringritjen e PD-së, kur u tha se ai e bën për veten e tij, ashtu dhe në zgjedhjet e fundit lokale, ku dyshimet e votave sapo nisën të kapin vërtetësinë në Rrogozhinë, ku do të përsëriten votimet, Berisha u lidh me mijëra votues që e mbështesin, por falë situatave që rrodhën me ligjet dhe Komisionit Zgjedhor, nuk u mundësua vota e mijëra të tjerëve të pakënaqur në një mënyrë që pjesa tjetër e fluskës së premtimeve boshe vetëm mund ta ëndërronjë. Ata janë të gjithë bashkë në këtë pikë. Ata janë edhe opozitarë, edhe Pozitarë. Edhe... Dhe ata kurrë nuk e kanë harruar apo falur për këtë. Por harrojnë. Harrojnë! Demokracia është

shumë më e madhe se Berisha. Ata janë thjesht hakmarrja.

Hakmarrja e fushatës së tillë u ekspozua plotësisht edhe nga situata që po ndodh në atë që mediat e quajnë, 'Partinë e Vulës'. Ata vetë tashmë janë në dilemë. Janë vetë të ndarë. Apo mos vallë edhe atje i ndau përsëri Berisha?! Nga ana tjetër skandali i seksit në zyrat qeveritare, tashmë i përsëritur me të zgjedhurit lokalë në krahun e Pozitës qeverisëse është një faktor tjetër në këtë pikë politike dhe injorante, që vërtitet e mbahet në praktikë mes armiqësish, kontradiktash, kryeneqësish, arrogancash. Ajo që foli hapur me videon e publikuar në Kukës ka një diksurs më vete, mbase më shumë se sa sqarimi publik i vetë protagonistit të këtij turpi të përsëritur. Padyshim, gjithkund ka një rrezik nga armiqësitë, por në këtë kënd tregojnë e ritregojnë me fakte që janë më shumë se sa një 'mëri' personale.



NJË LIBËR ME VLERA STUDIMORE TË TIMO MËRKURIT

Enëse shkon në thellësi ndjen mushtin e një prodhimitarë të mbarë “studimore”. Është një kohë e gjatë e përkushtimit të Timo Mërkurit në këtë fushë të ndjeshme e të arsyeshme në prurjet e tij të njëpasnjëshme. Ndërkohë ai e ka dhënë rezultatin me kohë. Kësaj radhe ndalet tek një emër, një poet, që ka bërë vendin e tij në tërësinë krijuese poetike. E ndalesa tek poeti Niko Kacalidha, nuk ka sjell vetëm një studim të mirëfilit, por një vepër që tashmë flet mjaft

+/-im. Pra, është një emër: blatim dhe në shumës mbetet si i pacaktuar, duke na formuar pikërisht fjalën “blatime”, që në numrin njëjës është i caktuar si “blatimi”, dhe sërish në shumës i caktuar me “blatimet”. Në kuptimin e parë jemi mësuar ta ndjejmë si oferta. Pra, më parësisht, emërtimi kuptohet si i tillë, të cilin e plotësojmë me një deklinsion të vetë blatimit. Gerundet si ky emër, përfundojnë me -im dhe shumësohen në -ime, sikurse e cituam në shpjegimin tonë të shumës

sistematike të poezisë së poetit, të ndërthurur dhe plotë kontekste filozofike në tërësinë krijuese poetike të poetit Niko Kacalidha, sidomos tek vëllimi poetik “Heraldikët e borës” (Kacalidha, 2022).

Këto poezi të këtij vëllimi, sipas Mërkurit na jepen se janë aq të mbushura me gjuhë figurative, sa që ndonjëherë mund të ndihet si një kod. Për të mbajtur gjurmët e asaj që po ndodh, mund të jetë e dobishme të lexohen poezitë e shumta si një metaforë në të njëjtën kohë, ndaj Mërkuri shprehet se “Poezia e Kacalidhës është një poezi surrealistike metaforike” (Mërkuri; 2023:140). Le të fillojmë me referencën e takimit të Timos me “Heraldikët e borës”, ku sundon një mënyrë metaforike ndryshe, dhe më pas për të krahasuar konsideratën e Mërkurit për ciklin “Puhiza e barit” (Kacalidha; 1969-1974). shihet se në tërësinë e kësaj trajtëse të Mërkurit kjo gjuhë figurative është thellësisht ironike. Poeti Kacalidha, përdor një formë dhe strukturë poetike të fuqishme për të shpëtuar nga ndikimi i kësaj të fundit nga soc-realizmi, dhe për të pasur thujtë në tërësi një rrugëtim poetik të ndjeshëm metaforik. Krahasimi është i fuqishëm në vetvete, por gjithashtu sugjeron, më gjerësisht, se bukuria natyrore e mjedisit të poezisë së Kacalidhës është e pakomprometuar nga faktori kohë, hapësirë dhe vend. Për këtë Mërkuri shprehet: “Përtej kuptimshmërisë së poezisë dhe metaforës së saj, ajo që më bëri përshtypje të madhe ishte forma e paraqitjes si një poezi në prozë dhe kjo ishte një shtysë e fortë për ta lexuar gjithë ciklin “Blatimet e borës” të kësaj përmbledhjeje me vëmendje të madhe (Mërkuri, 2023:136).

Në këtë aspekt filozofik të analizës teorike Timo Mërkuri

i jep lexuesit një strategji ndryshe që të ketë mundësinë të njohë autorin në thellësi të vetë konceptin, sikurse ndodh “Takimi me “Heraldikët e borës”; apo dhe me mënyrën e trajtimit të “Pushteti i të bukurës dhe ekehira”; “Gjuha poetike e Niko Kacalidhës”; “Mali dhe Deti ...”; po aq sa “... dashuria, forma estetike, filozofia, zogjtë, vajtimi, gjuha, mikrobota, metempsikoza” etj., në poezinë e autorit të marë në konsideratë.

Duke analizuar thellë dhe me strukturë adekuate studimore, Timo Mërkuri, përveç elementëve metodologjikë, angazhimit të tyre, të tjerat thuajse i ka renditur formativisht në aspekte që formojnë rregullin e qasjes së tillë, duke i bërë të njohur lexuesit hyrjen e autorit në poezinë shqipe, ndikimet e artit gojor në poezi, dhe duke sistemuar mirë dhe ndjeshëm vargun, fjalën dhe stilin që përdor poeti. Autori i këtij libri të përkushtuar për Niko Kacalidhën na jep mjaft të dhëna të njohura e të panjohura për poetin, dhe na saktëson tërë udhën e tij krijuese, letrare dhe poetike, duke e bërë kështu këtë libër dhe si një monografi me vete.

Duke përfunduar në këtë shkrim të shpejtë, pas leximit të tij në udhë e sipër për në punë, mbetet natyrshëm jo thjesht vëmendja për poetin Kacalidha, ku Mërkuri shprehet “Poezia në prozë një kuotë e lartë e Niko Kacalidhës”, por edhe pse ky libër nuk është thjesht një sprovë, sikurse e cilëson autori, por një vlerë e shtuar në angazhimin e madh e të gjithëanshëm krijues, poetik, letrat të Timo Mërkurit. Sakaq “Blatime poetike të Niko Kacalidhës” (2023) mbetet një libër i ndjeshëm, tërheqës, dhe i estetizuar bukur nga të dy palët, edhe nga autori i tekstit, edhe nga botuesi i librit.



mirë me strukturën, kontekstin, prezantimin, analizën dhe diskursin e vetë. Autori e ka titulluar “Blatime poetike të Niko Kacalidhës” (2023) dhe botimin e ka kryer një nga institucionet më serioze të botimit të librit në Shqipëri, “Onufri” e Bujar Hudhrit.

Përpara se të futemi në një lexim më të thellë, është mirë t'i hedhim një sy titullit të studimit në fjalë. Ndërsa jemi tek titulli, natyrisht në ndjesinë e autorit Mërkuri, kanë perceptim “flijimet” të cilat poeti Kacalidha, në poezitë e tij i ka ridimensionuar, në thelbin etimologjik të blatimit.

Gerundi i blatës vjen e ndihmon formësimin nga blatë

dhe njëjësit. Format e njëjësit janë gramatikisht mashkullore dhe shumësi gramatikisht shkon tek format femëorë: një blatim i mirë — ofertë e mirë; dhe më tej blatime të mira — oferta të mira, ose më thjesht mund të shtjellohet e sqarohet me: dobishmëria e blatimeve të mira, ose edhe me: dobia e ofertave të mira. Në këtë kontekst vetë gerundi dhe emetimi që në titull i japin tërësisë në të cilën autori rrethotullohet të analizojë krijimtarinë poetike të Kacalidhës, një hierarki funksionale. Duke lënë të kuptohet se ekziston një hierarki e tillë, Mërkuri u kërkon lexuesve të marrin në konsideratë natyrën

NJË MONUMENT LETRAR PËR KRIJIMARINË DHE PËR KRIJUESIT SHQIPTARË NË SUEDI

Nga Rizah Sheqiri

Prof. Dr. Fatmir Terziu: "Influencia diskursive të krijimtarisë shqiptare në Suedi", studim, first published in the UK in 2023 by ACPE.

Studimi "Influencia diskursive të krijimtarisë shqiptare në Suedi" i prof. dr. Fatmir Terziut është një prurje e re e arrirë dhe e veçantë në fushën e studimeve letrare.

Ky studim, i pari i këtij lloji është dhuratë nga më të çmuarat, që i bëhet gjithë komunitetit shqiptarë, veçanërisht krijimtarisë së gjithë krijuesve letrar në Suedi, por e më gjërë. Ky studim për krijimtarinë dhe për krijuesit shqiptar në Suedi është i një rëndësie tepër të veçantë, ngase është bërë me kompetencë të lartë shkencore dhe nga një studiues i mirëfilltë Prof. Dr. Fatmir Terziu, i cili është nga të parët studiues që në mënyrë kaq serioze trajton vlerat letrare që sjell letërsia shqiptare, e cila krijohet në diasporë, konkretisht në Suedi.

Prandaj studimin si të tillë dhe botimin e tij në një vëllim të veçantë, unë personalisht e vlerësoj si një nga ngjarjet e një rëndësie tepër të veçantë kulturore e historike. Ngase prezantimi i këtij studimi u bë në festivalin e dymbëdhjetë "Sofra poetike" në Borås më 3 qershor dhe më 5 qershor në Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë "Ura" në Uddevalla, që u mbajt në vigjilie të 500 vjetorit të themelimit të Suedisë si shtet dhe për nder të ditës kombëtare të Suedisë

6 qershorit. Për këtë arsye, konsideroj unë, ky studim dhe përrurimi i tij merrë edhe një dimension tjetër të një rëndësie të veçantë dhe vjen si një mirënjohje, nga më të lartat, ndaj vlerave njerëzore, kulturore e letrare që krijohen në Suedi, qoftë nga vendasit qoftë edhe nga krijuesit shqiptarë që jetojnë, veprojnë e krijojnë këtu. Prezantimi i këtij studimi të veçantë në këto rrethana i jep edhe më shumë kuptimësi gjithë aktivitetit letrar e kulturor të këtyre ditëve dhe nderon në mënyrën më të mirë komunitetin shqiptarë dhe miqët e tij suedez duke i pasqyruar denjësisht e me shumë kompetencë prej studiuesi gjithë vlerat, punën dhe angazhimin e intelektualëve shqiptarë, krijuesve letërar e artistikë, qoftë si individ, qoftë si komunitet, edhe në raport me vlerat që krijohen në atdhe dhe me ato vlera që krijohen, vlerësohen e lartësohen në Suedi.

Momente nga prezantimi i studimit "Influencia diskursive të krijimtarisë shqiptare në Suedi" në Festivalin Ndërkombëtar të Poezisë "Ura" në Uddevalla të Suedisë më 5.6.2023. Këta krijues letrar me krijimtarinë e tyre, me fjalën e tyre artistike, me punën dhe me kontributin e tyre janë bërë edhe ura të qëndrueshme miqësie mes letërsish, mes kulturash, mes gjuhësh e mes popujsh. Kështu pra, në studimi "Influencia diskursive të krijimtarisë shqiptare në Suedi" i prof. Dr. Fatmir Terziut i trajton, shqyrton e analizon këto dhe shumë aspekte tjera të krijimtarisë letrare e artistike



të krijuesve shqiptarë; qofshin ata poet, shkrimtar, historian, eseistë a gazetar, të cilët punuan, veproun e krijuan më heret dhe kryesisht të atyre që punojnë, veprojnë e krijojnë në ditët tona në Suedi. Krijimtaria dhe kontributi i tyre analizohet dhe pasqyrohet më mirë se kudo tjetër në këtë studim të thukët, të bërë me kompetencë e ndjesi prej një shkenctari, analisti, studiuesi dhe krijuesi të përkushtuar dhe me shumë eksperiencë. Falenderime të përzemërta prof. dr. Fatmir Terziu që na nderove neve, komunitetin krijues e letrar shqiptar këtu në Suedi, duke mos i harruar as ata që veproun më heret. Por duke mos i harruar edhe përkrahësit krijues letrar a përkthyes miqët e krijuesit vendas të më hershën dhe ata që veprojnë e krijojnë sot. Pra ky studim u bën nder edhe miqëve tanë të shumtë krijues suedez që vazhdimisht kanë qenë dhe janë një ndihmë e madhe për

për krijuesit shqiptarë këtu dhe më gjërë. Gjithësesi nderin që u bën krijuesve shqiptarë dhe krijimtarisë së tyre në Suedi do ta përjetojnë edhe miqët krijues vendas, aqë më tepër kur ky studim shumë shpejtë do të përkthehet e botohet pos në gjuhën angleze edhe në gjuhën suedeze.

I nderuari Prof. Dr. Fatmir Terziu juve ju uroj shëndet e shumë suksese të reja në punë e në jetë, ndërsa studimit tuaj "Influencia diskursive të krijimtarisë shqiptare në Suedi" sa më shumë lexim, analizë e shqyrtim nga lexues, krijues e studiues. Studimi juaj uroj që të jetë edhe një bazament i fortë dhe pikë e denjë referimi për studiues të sotshëm e të ardhshëm!

Respekt e falenderime për punën tuaj të çmuar dhe urime të përzemërta edhe shumë e shumë suksese të reja në fushën e krijimtarisë dhe në fushën e studimeve letrare!

NATA E ELBASANIT - N'TRADITË SHOW

Prej disa kohësh në një nga ekranet e televizioneve, pikërisht televizionit "Fax News" po ndjehet fryma e rigjallërimit të disa vlerave të muzikës qytetare shqiptare. Kjo ringjallje vjen këtë herë me emisionin N'Traditë Shoë. Pas disa emisioneve të tilla nga disa qytete të Shqipërisë, ajo që pamë dhe ndjemë para disa ditësh në këtë pikë si të tillë, ishte Nata e Elbasanit - N'Traditë Show (20 Maj 2023). Vështrimi i parë natyrshëm solli në vëmendje një nga fizarmonicistët më në zë të qytetit, Sopot Sericën, që vjen nga një rrënjë me tradita të thella të muzikës elbasanase, të cilat e ushqyen atë që në moshë të re kur i ati, i ndjeri Rrustem Serica interpretonte në disa vegla muzikore dhe ngrinte peshë zemrat elbasanase.

Ky ekran i dashur tashmë për shikuesit sjell këtë emision në moderimin e zonjës Albana Qiriako, dhe në ndjesinë profesionale të ideatorit dhe mikpritësit, Bujar Cici "Mjeshtër i Madh", ku fjalën tjetër si organizator e ka Mentor Sallaku dhe bën atë që në pak javë të rikthejë mjaft vlera dhe të zbulojë shumë talentë.

Ky emision i shkëlqyer i realizuar dhe transmetuar më 20 Maj në mbrëmje në N'Traditë Show në Fax News, me pjesëmarrjen e artistëve më të mirë të kohës së qytetit të Elbasanit, edhe në planin artistik solli mjaft risi të reja. Krahas emrave të njohur si këngëtarë elbasanas, i quajtur bilbili i këtij qyteti, Mustafa Mehja, që interpretoi mrekullisht disa këngë qytetare elbasanase të repertorit të tij të mirrënjohur, ky emision solli dhe emra të rinj dhe talentë që janë e ardhmja e këngës së tillë.

Me pjesëmarrjen e këngëtarëve të njohur, vëllezërve Taulant e Vilson Myzeqari, Dritan Mustafaj, Iris Sula, Sergita Varfi, Melola Gaxho emisioni N'Traditë

Show solli një spektakël të vërtetë vlerash. N'Traditë Show jo vetëm që rikthen një traditë, por dhe prezanton këngëtarët që bënë zë në vite dhe ata që janë në gjurmët e tyre. sikurse thuhet nga vetë prezantuesit e gjithë kjo përbën një risi që e bën tërësinë. Elidhjeve profesionale si një pjesë integrale e njëri-tjetrit.

Grupi muzikor Sandër Gjoka në Kitarë, Bledi Mbroce në Bateri, Ilir Sula në Klarinet, Bastri Baçova në Organo dhe drejtues Sopot Serica natyrshëm i dhanë jetë këtij emisioni ku spikati jo vetëm ajo që pritej por dhe muzika tradicionale elbasanase si një arsye më shumë në rizgjim të vlerave. Kjo bëri që të mirëkuptohet dhe një herë ajo që është thelbësore se muzika tradicionale mund t'i ndihmojë njerëzit të kuptojnë më mirë një vend, një qytet, një kulturë, në këtë rast sikurse ishte Elbasani. Kjo përfaqëson historinë, traditat dhe mendimet e një komuniteti dhe në gjerësinë prezantuese dhe ato vlera që i japin peshën vetë emisionit në fjalë. Për shembull, muzika popullore elbasanase është jashtëzakonisht e larmishme dhe shpreh aktivitetet kulturore shpirtërore të banorëve të kësaj treve.

N'Traditë Show vërtetoi me forcën e tij thelbin se muzika është një pjesë e brendshme e kulturës njerëzore dhe luan një rol të rëndësishëm në jetën elbasanase. Ky emision

sikurse u pa synoi të eksplorojë rëndësinë e muzikës dhe shqyrtoi elementaren e thellë të qëllimit se nëse vërtet muzika tradicionale ka një rëndësi po aq të madhe sa muzika ndërkombëtare në botën e sotme të globalizuar. Një nga arsyet kryesore pse kemi nevojë për muzikë të tillë është aftësia e saj për të ngjallur emocione dhe për të përmirësuar ndjesinë tonë. Muzika natyrshëm, në përgjithësi dhe ajo elbasanase ka një ndikim të thellë në disponimin qytetar, duke lehtësuar stresin dhe duke ofruar rehati dhe ngushëllim. Ajo shërben si një gjuhë universale që kapërcen barrierat dhe i lejon individët të lidhen me veten e tyre të brendshme dhe me të tjerët. Për më tepër, muzika shërben si një mjet i shprehjes kulturore dhe promovimit të identitetit kulturor. Muzika tradicionale e këtij emisioni, që pati në themel muzikën elbasanase mbarti trashëgiminë e njerëzve të tij, historinë, vlerat dhe zakonet e tyre. Emisioni dhe muzika e tij shërbeu si një arkiv kulturor, duke pasqyruar trashëgiminë unike të një kombi dhe duke ofruar ndjenjën e përkatësisë ndaj qytetarëve të tij.

Megjithatë, në botën e sotme të ndërlidhur, muzika ndërkombëtare është bërë gjithnjë e më e përhapur. Ai ofron një platformë për shkëmbimin ndërkulturor dhe u lejon individëve të vlerësojnë stile dhe zhanre

të ndryshme muzikore. Muzika ndërkombëtare nxit mirëkuptimin kulturor dhe promovon unitetin midis njerëzve me prejardhje të ndryshme. Ndërsa muzika tradicionale ka rëndësi kulturore, është e rëndësishme të njihet vlera e muzikës ndërkombëtare në pasurimin e përvojave tona muzikore. Bashkëpunimet muzikore globale dhe shkrirja e stileve të ndryshme mund të çojnë në krijimin e melodive novatore dhe magjepsëse që rezonojnë me një audiencë më të gjerë.

Si përfundim, muzika shërben si një gjuhë universale që ngjall emocione, promovon mirëqenien dhe nxit shprehjen kulturore. Ndërsa muzika tradicionale është jetike në ruajtjen e trashëgimisë kulturore, muzika ndërkombëtare ka meritat e veta në promovimin e mirëkuptimit dhe vlerësimit ndërkulturor dhe që të dyja kanë një efekt të madh. Në vend që ta shikojmë muzikën tradicionale dhe ndërkombëtare si ekskluzive reciproke, është thelbësore të përqafohen të dyja dhe të festohet pasuria dhe diversiteti i shprehjeve muzikore. Ky emision i bukur e ka bërë këtë me idenë dhe çelësin e për një hapësirë të re dhe më të gjerë muzikore. Të tjerat janë dhe duhet të jenë dhe syri e veshi i Qeverisë, që duhet ti shikojë dhe vlerësojë si duhet artistët, që janë thesari përcjelljes së traditës tek brezat.



PUSHO NË PAQE VIOLETA KAPXHIU SULKUQI!

Violeta Kapxhiu Sulkuqi nuk ishte vetëm një përkulje respekti dhe talenti mbi piano. Ishte muzikë dhe muzikalitet jete dhe frymëzimi, përkushtimi dhe përcjelljeje mesazhiere të vetë simbolikës së dashurisë tek brezat. Ajo nuk mund të thuhet ishte, edhe pse tashmë është një veprim hyjnor në këtë pikë, por do të jetë dhe do të mbetet se do të shërbejë dhe me shpirtin e saj. Të paktën kështu lexohet nga dashuria e zemrës së saj nga i biri muzikant. Dhe kjo mbetet më shumë se një dhimbje në prononcimin e tij shumë të ndjeshëm dhe të thellë. Por, i dhimbshëm prononci publik i violinistit Zisimos Florenc Sulkuqi, për humbjen e nënës së tij “Bëjeni udhëtimin, Engjëlli im!”. I dhimbshëm dhe lajmi i hidhur i ikjes së një artisteje elbasanase që i dha shumë me talentin e saj artist, kulturës dhe brezave. Sa vetë janë nderuar me përkushtimin e saj. Savvetë tashmë janë në përkuljen e lehtë ndaj shpirtit të saj.

E ndërsa ajo tashmë udhëton me muzikalitetin e saj melodik në shpirtat e përlotur udha tregon se ajo ishte dhe mbeti një kolonë me të shoqin e saj, Zeqirin që natyrisht nuk nihet vetëm nga violina e tij e papërsëritshme. E kështu kujtojmë... “Karantina nuk i pengon artistët nga Elbasani të luajnë muzikë (Maj 2020.); “Zeqiri nuk është i vetëm në këtë situatë, pasi në krah ka edhe bashkëshorten e tij, Violeta Sulkuqi, prej vitesh pianiste. Përmes tingujve të bukur të instrumenteve të tyre muzikor, Violeta dhe Zeqiri, me meloditë që luajnë argëtojnë

edhe komshinjtë që kanë fatin t’i kenë pranë dhe çdo ditë të gjejnë pak qetësi në tingujt e mrekullueshëm të muzikës së bashkëshortëve Sulkuqi.” Talentet që dolën nga duart e saj heshtin dhe mbeten të habitur. Çmimet e marra

Elbasanit shkruhet nga mjaft të tillë se “dua t’ja kushtoj një pedagogeje shumë speciale, që përkushtimi, puna e mrekullueshme, profesionalizmi, dashuria e madhe për nxënësit më ka habitur dhe frymëzuar, Violeta

shprehet mes dhimbjes “Do të kujtojmë gjithnjë kështu...

plot mirësi, e buzëqeshur, plot pasion, profesioniste, e përkushtuar, e palodhur, më shumë se mësuese, e pazëvendësueshme Violeta

Sulkuqi Kapxhiu. Shumë i parakohshëm largimi yt, nuk ka fjalë... Shpirti yt i bukur u prehtë në paqe. Do mbetesh gjithnjë në zemrat tona. Falenderojmë Zotin për të gjitha momentet e bukura dhe plot emocion që kemi përjetuar bashkë.”

Suzana Laska Basko për këtë laj të hidhur shkruan “Ka në jetë nga ata njerëz që, kur i takon e di që do të ngelen gjithmonë në zemrën dhe mendjen tënde. E veçante, e bukur, e ëmbël, profesioniste e shkëlqyer, nënë dhe bashkëshorte e denjë. Na copëtove zemrën Violetë (Iulja e bukur dhe e hijshme, si ta besoj rrugëtimin tënd, do të doja dikush të më thotë:- Ka shkuar diku dhe kthehet më vonë. Lamtumirë Engjëlli i mirësisë!” Pothuajse me dhimbje shprehen Brunilda-

Eygenia Malo, Lusena Libohova Graca, e më tej Ladi Musaj ka shkruar një elegji me titullin në germa të mëdha VIOLETA dhe me përkushtimin, Elegji për mësuesen e pianos së shkollës së muzikës Onufri.

Ende nuk dihet se si e përjeton dhe i fshin lotët e saj poetike Iliriana Sulkuqi, poetja që bashkëjetoi dhe bashkëjeton me dhimbje të tjera ikjen e kunatës, që e kishte simotër.



gjithëandëj nuk numërohen. Dhe ja kujtesa na sjell në majin e vitit 2014-të në Prishtinë ku ajo do të nderohej me “ESTA Kosovë për harkor më të suksesshëm” e shpërblyer së bashku me profesoreshat e tjera të muzikës: Brunilda Stefani dhe Radmilla Popovska.

Mbas çdo nxënësi të suksesshëm është një mësues i përkushtuar! Këtë sukses të shkollës së pianos së

Sulkuqi Kapxhiu! Suksesi i studentëve të Elbasanit është meritë e madhe e jotja e dashur Violeta! E ajo udhëtoi e u nderua dhe Dürren NRË të Gjermanisë, në Grac të Austrisë me tingujt që ia prodhoi shpirti dhe zemra. Ndiqni papushim duartrokjet për këtë mjeshtre deri në infinit...

Kastriot Tusha shkruan me dhimbje të madhe familjare dhe intelektuale. Enereida Omeri

JASHTË STEREOTIPEVE NEGATIVE TEK EMOCIONI I NJË ROMANI



Eveçanta për romanin “Në anën tjetër” nga Teuta Metra është origjinaliteti i tij, duke arritur në ekscentricitet, pra kualitet narrativ që del mrekullueshëm nga rrethi i tërësisë. “Në anën tjetër” mund të lexohet si një libër i zakonshëm, por mund të filloni edhe nga çdo faqe të mendoni për më shumë rreth kualitetit narrativ. Një peizazh i pikturuar me atmosferë, është një roman me një fjalëkryq të thellë e të përfshirë në tërësinë e tij diskursive. “Në anën tjetër” është jo thjesht një arsye, as thjesht një udhëtim, nuk klasifikohet thjesht si një dhimbje, por si një diskurs më vete që perfshin ngjarje të cilat përjetohen ndoshta nga shumë njerëz e nga shumë gjuhë.

1. Ky roman është shkruar në formën e një strukturimi te mirrefillte. Kuverta mistike përdoret për të qasur forcën e diskursit dhe për të dhënë më shumë detaje që përfshihen në në roman. Rrëfimi sillet rreth fateve njerëzore dhe i zhyt plotësisht lexuesit në aspekte që kanë të bëjnë Rita Hanën nga Shqipëria, të ndërthurura me mjeshtëri

me besëtytnitë realiste, nëse mirëkuptojmë ndryshimin e jetës së saj pas vdekjes së nënës. Aspekte të tjerë individualë mund të lexohen në mënyrë të pavarur, secili personazh është i vetëdijshëm për rolin dhe vendin e tij në vend, hapësirë dhe kohë dhe lexuesi shpesh mbetet i habitur nga mesazhet e tyre që kufizohen me absurdin.

2. Kështu kur Babai i Ritës u martua përsëri dhe gruaja e tij e re nuk donte që Rita të qëndronte në shtëpinë e saj, i dashuri i Ritës, Samueli, ishte i vetmi person që i kishte mbetur. Në këtë pikë edhe vetë Samueli ishte rrugës për në Londër, ku synote të shkonte për të studiuar. Në roman gjejmë premtimin e thellë e të domosdoshëm që komunikon si traditë, shtjellim dhe vazhdim të asaj që vjen nga rrënjët kur Samueli i premtonte Ritës se do të fillonin një jetë të re së bashku në Londër. Në anën tjetër është edhe shqetësimi prindëror, i cili në roman nënkupton shumë, pikërisht atë që lidhet me vendin e origjinës, pasi lexuesi e nënkupton këtë kur Rita u shqetësua kur ajo nuk dëgjoi asgjë nga Samueli. Kjo e shtyn Ritën të marrë një vendim. Rita në lexim e sipër mësojmë se vendosi të shkonte në Londër për ta kërkuar Samuelin, por nga ana tjetër ligji dhe ligjësitë e lëvizjes së lirë natyrshëm sjellin edhe problematikën tjetër. Në këtë pikë Rita është e vetëdijshme se do

të ishte e vështirë të hynte në vend, pasi më së shumti perceptimi shkonte tek ajo që thuhej eshkruej për vendin e saj të origjinës. Pra duke ditur se kishte një stigmë ndaj njerëzve nga Shqipëria dhe Rita mund të hynte në Londër vetëm ilegalisht, ose me dokumente false, është një pikë tjetër në roman, që shkon natyrshëm nga kahja e leximit mediatik, se sa në tërësinë narrative që duhet të përshkojë një roman me detaje, të cilat ndoshta autorja i ka pasur të vështira për t'i siguruar. Diku në këtë kënd mësojmë se Rita nuk e kishte idenë se çfarë i priste gjatë udhëtimit të saj.

3. “Në anën tjetër”, Teuta Metra, na paraqet një ndërthurje marramendëse të modernitetit, imagjinatës së shfrenuar dhe alegorizmit, dhe për qershinë mbi tortë do të gjeni një dozë të madhe kiberpunk. Personazhi në tërësinë e tij është lëvizës dhe vetë romani në kahun e tij është është plot aksion dhe emocioni fillon që në kapitullin e parë. Komploti mbetet sa origjinal dhe aq i ekzekutuar pa ndonjë sforcim, duke e bërë dhe leximin të lehtë e të mjaft mirë, të kuptueshëm. Me të gjitha format narrative që karakterizohet romani vjen në risinë kryesore të tij tek romanca, që qaset në rritje mes gjithë dramës. Historia është një formë dhe një forcë që buron nga dëshira dhe talenti i autores, dhe natyrshëm

duket se është e shkruar mirë dhe emocionuese.

4. Dy botët, që mbetin në roman, një e dukshme dhe një e padukshme, fillojnë të ndërthuren në një mënyrë të paimagjinueshme, derisa më në fund ato bashkohen dhe për herë të parë ata rrëfejnë, karakterizohen dhe mirëkuptohen, ndaj vetë protagonistin ndihet i lirë nga kontrolli gjithëpërfshirës i shoqërisë mbi individin. “Në anën tjetër”, është një shembull i rrallë i një romani postmodern me thellësi intelektuale të lakmueshme dhe kompletim stilistik, me përshkrime të jetës nga erdhi Rita, si p.sh. petulla tradicionale shqiptare që i bënë halla e saj dhe vështirësitë me të cilat ajo përballlet si e re në vendin e saj me pak para apo mbështetje, pra është një roman dhuratë nga një autore e guximshme me një vizion origjinal të shkrimit.

5. Ky roman ndryshe mund të klasifikohet si një aspekt i gjerë dhe i gjallë për dashurinë, humbjen dhe tradhtinë. Forca tjetër tërheqëse vjen kur lexon momentin apo situatën tek treni, lidhjet dhe arsyet e një dashurie, personazhi që kërkon më shumë vëmendje si Andreë, apo e ardhmja në një vend tjetër, e mjaft të tjera, deri ku natyrshëm bien në sy stereotipet dhe pikëpamjet negative të trashëgimisë shqiptare.

BEYOND NEGATIVE STEREOTYPES TO THE EMOTION OF A NOVEL

What is special about the novel "On the other side" by Teuta Metra is its originality, reaching eccentricity. "On the other side" can be read like an ordinary book, but you can also start from every page to think about more. A landscape painted with atmosphere is a novel with a deep crossword puzzle included in its entirety. "On the other side" is not simply a reason, nor simply a journey, it is not simply classified as a pain, but as a discourse in itself that includes events that may be understood by many people and by many languages.

1. This novel is written in the form of a well-structured structure. The mystical deck is used to access the force of the discourse and to give more details that are included in the novel. The narrative revolves around human destinies and completely immerses the readers in aspects related to Rita Hana from Albania, skilfully interwoven with realistic superstitions, if we understand the change in her life after the death of her mother. Other individual aspects can be read independently, each character is aware of their role and place in country, space and time, and the reader is often surprised by their messages that border on the absurd.

2. So, when Rita's Dad

remarried and his new wife didn't want Rita to stay at her house, Rita's boyfriend, Samuel, was the only person on her side. At this point, Samuel himself was on his way to London, where he intended to go to study. In the novel we find the deep



and necessary promise that communicates as tradition, elaboration, and continuation of what comes from the roots when Samuel promises Rita that they would start a new life together in London. On the other side is the parental concern, which in the novel means a lot, precisely what is related to the place of origin, as the reader implies this when Rita was worried when she did not hear anything from Samuel.

This prompts Rita to decide. In the above reading, we learn that Rita decided to go to London to look for Samuel, but on the other hand, the law and the legalities of

free movement naturally bring other problems. At this point, Rita is aware that it would be difficult to enter the country, since the perception mostly went to what was said to be written about her country of origin. So, knowing that there was a stigma against people from Albania and Rita could enter London only illegally, or with false documents, is another point in the novel, which goes naturally from the direction of the media reading, then in the narrative as a whole that should traverse a novel with details, which the author may have had difficulty in providing. Somewhere in this corner we learn that Rita had no idea what awaited her during her journey.

3. "On the other side", Teuta Metra, presents us with a dizzying combination of modernity, unbridled imagination and allegorism, and for the icing on the cake you will find a large dose of energy. The character in his story is moving and the novel itself in his direction is full of action and excitement starts from the first chapter. The plot remains as original as it is executed without any effort, making it easy to read and quite well, comprehensible. With all the narrative forms that characterize the novel, it comes to its main innovation in the romance, which approaches growth among all the drama. The story is a form and a force that springs from

the desire and talent of the author, and naturally it seems to be well written and exciting.

4. The two worlds that remain in the novel, one visible and one invisible, begin to intertwine in an unimaginable way, until finally they unite and for the first time they confess, characterize, and understand each other, so the protagonist himself feels free from society's comprehensive control over the individual. On the other hand, it is a rare example of a postmodern novel with enviable intellectual depth and stylistic completion, with descriptions of the life Rita came from, such as the traditional Albanian pancake that her aunt makes for her and the difficulties she faces as a young woman in her country with little money or support, so it is a gift novel from a brave author with an original vision of writing.

5. This novel can otherwise be classified as a broad and vivid take on love, loss, and betrayal. The other attractive force comes when you read the moment or the situation on the train, the connections and reasons of a love, the character that requires more attention like Andrew, or the future in another country, and many others, until the stereotypes and views naturally stand out. negative aspects of Albanian heritage.

PROF. ZOJA BOZGO NJË EMËR QË NUK DO TË HARROHET LEHTË

Një lajm i dhimbshëm ka ardhur sot përmes mediave sociale për ndarjen nga jeta në moshën 89 vjeçare të Profesoreshës Zoja Bozgo. Ky lajm mbetet i tillë jo vetëm për të afërmit e saj, por dhe për qindra e qindra breza nxënësish e studentësh që mësuan matematikën me talentin e aftësinë e saj të veçantë. Zoja Bozgo, ishte vlerësuar me shumë çmime dhe ishte “Mësuese e merituar”, por çmimi më i madh për një edukatore si ajo ishte dhe mbetet dashuria dhe respekti që ajo ndau me të gjithë.

Zoja Bozgo, e shkolluar për mësuesi në Rusi, e ardhur 60 e ca vjet më parë në Shqipëri, u befasua me traditën arsimore të Elbasanit, kryesisht përmes normalistëve-pedagogë, të gjimnazit ku punoi. Diplomohet në Universitetin shtetëror të Shën-Petërburgut, në fakultetin e matematikës. Kur vjen në Shqipëri fillon detyrën e pedagoges në Universitetin e Tiranës, në katedrën e matematikës. Në vitin 1976,

me një urdhër “qarkullimi” do të vendoset në Elbasan, duke filluar punë në gjimnazin “Dhaskal Todhri”, si mësuese e matematikës deri në daljen e saj në pension. Më pas do të jetë pedagoge e jashtme në Institutin e Lartë Pedagogjik. Me sjelljen e punën e saj shembullore, përcolli plot dinjitet një emër të mirë, me konsiderata të larta nga kolegët, nxënësit. Edhe sot e kësaj dite, sikurse nxënësit e mësuesit e gjimnazit, ruajnë kujtime nga më të mirat, si specialiste, metodiste, si njeri në kuptimin më të mirë të fjalës. Zoja Bozgo shquhet për mbështetjen dhe përkushtimin që tregon për nxënësit e talentuar. Njihte shumë mirë psikologjinë moshore. Ajo dinte jo vetëm shtyllat e lëndës ku duhet të mbahet nxënësi, por u tregonte edhe shkallët për t’u ngjitur hap pas hapi. Zojës i treteshin minutat pa u kuptuar, duke gozhuar vëmendjen e nxënësve, që bluanin operacione matematike me logjikën e tyre, mprehin aftësinë e gjykimit matematik. Me interesimin që u kushtonte nxënësve

të talentuar, po me aq vëmendje punonte edhe për të njohur dobësitë e çdo nxënësi, po me aq saktësi për caktonte “terapinë” dhe intensivisht i “ushqente” me material sipas programit. Ishte një metodiste e saktë dhe shumë punëtore. Asnjëherë nuk punoi për vete, por dha gjithçka për shkollën. Dha shembullin se si mund të dilet nga konformizmi burokratik në punën me talentet, duke u shkëputur nga format tradicionale të organizimit të punës me to; doli nga kornizat e programeve simbolike e akademike të rretheve jashtëshkollore. Gjeti forma të tjera nxitje e frymëzimi, duke ndryshuar pozitën e saj nga mësues- lektor, në udhëheqjen shkencore me bashkëpunëtorë. Kujtesa kolektive e nxënësve që mësoi dhe e mësuesve që



bashkëpunoi, plotësojnë portretin e saj si mësuese e talentuar dhe qytetare e denjë. Mirënjohje për mësuesit e nderuar të qytetit tim!

Së fundi, dhe kjo pas viteve të monizmit, në periudhën e Demokracisë, ajo ishte dhe një nga gjashtë anëtarët e Komitetit ORSA. Pra, Zoja Bozgo, së bashku me Suzana Karagjozi, Diana Mitrushi, Arjana Risilia, Jana Mataj dhe Ilir Myteveli ishin drejtuesit e shoqatës së bashkëatdhetarëve rusë në Shqipëri.



+



PROFESIONALIZËM • GARANCI • CILËSI



**ABONIME
INSTALIME
RIMBUSHJE**


PËR MË SHUMË KONTAKTO GËZIMIN: 078 157 359 45



ARYA FOOD CENTRE



GËZUAR MUAJIN E MADHËRUESHËM TË RAMAZANIT



Adresa:

159-160
PARROCK STREET
GRAVESEND
DA12 1ER



KUR SHEMBULLI I STEPHEN MORRIS NGACMON MEMORJEN

Kur erdha në fillim në Mbretëri të Bashkuar m'u duk se isha në vitet tetëdhjetë kur nënat, gjyshet dhe të gjithë pothuajse anëtarët e familjes dilnin në qytet dhe spërkatnim me ujë rrugën përpara shtëpisë dhe e fshinin atë thuajse të gjitha mëngjeseve. Ne të gjithë mblidhnim mbeturinat dhe plehrat me kujdesin më të madh për të mbajtur pastërtinë e ambientit. Pse e them këtë, pasi të njëjtën gjë shikoja në disa lagje të Mexborough në South Yorkshire, kur burra e gra dilnin dhe përkujdeseshin njësoj për pamjen dhe hapësirën para dhe pas shtëpive të tyre. edhe një fotografi e vitit 1938, të cilën e shoh disa herë në rrejetet sociale, me tematikën "Një zonjë pastron pragun e saj" (Viti: 1938) e realizuar në Wake Street, pak larg Lambeth Ëalk më flet për këtë qasje dhe ngjashmëri. Në këtë fotografi disa nga të zotët e shtëpisë lajnë jo vetëm pragjet e hyrjes, por edhe një pjesë të madhe të trotuarit. Në shënimin e saj thuhet se "Është një zakon i rregullt i Vendit të Veriut, por mes tymit dhe papastërtive të Londrës duket një akt çuditërisht fisnik." Materiali është marrë nga artikulli "Jeta në shëtitjen e Lambeth". (Burimi: Picture Post. 31 dhjetor 1938).

Me këtë mendim udhëhoqa memorjen time derisa përpara disa ditësh përpara spitalit Charing Cross në Hammersmith pashë një burrë të moshuar që të mblidhte të gjitha hedhurinat dhe mbeturinat nga kalimtarët e shkujdesur në një qese të zezë. Kjo ndodh në rrugën kryesore, ndanë trotuarit që ndan kopshtin e ri me pemë e

lule nga Spitali Charing Cross, që është një spital akut i përgjithshëm i mësimdhënies i vendosur në Hammersmith, Londër, Mbretëria e Bashkuar. Spitali aktual u hap në vitin 1973, megjithëse fillimisht u krijua në 1818, afërsisht pesë milje në lindje, në Londrën qendrore.



U ndala dhe bëra më tej një bisedë me të. Me lejen e tij realizova edhe këtë fotografi. Ai më tha se quhej Stephen Morris. Nuk e pyeta për moshën, pasi në vetë pamjen e parë e ndjeva se tashmë ishte në pensionim. Në fakt kjo pamje e fiksuar më kishte bërë përshtypje disa herë. Më tej duke biseduar me z Morris mësoj se "Pacientët në spitalin Charing Cross prej vitit 2018 po përfitojnë nga një kopsht i ri i projektuar posaçërisht dhe që është i hapur në 200 vjetorin e spitalit." Ai më shpjegon se kopshti i financuar nga Imperial Health Charity,

është krijuar për pacientët me demencë, si dhe ata që shërohen nga një goditje në tru, ose që vuajnë nga një sëmundje tjetër neurologjike." Kështu duke biseduar me këtë njeri të sinqertë e mjaft aktiv mësoj se përdorimi i kopshteve spitalore është treguar se përmirëson shëndetin mendor dhe mirëqenien e pacientëve, kështu që me kopshtin në spitalin Charing Cross është transformuar përvoja e spitalit për pacientët tanë."

Ai më pyeti pse u ndala dhe nga jam. I shpjegova me pak fjalë dhe i tregova që në fillim se jam nga Shqipëria që jetoj dhe punoj në Mbretëri të Bashkuar prej disa vitesh. I them emrin dhe ai më thotë se diku të kam lexuar.

Më tej nuk e zgjat dhe më thotë se kohët e fundit ka lexuar një libër nga Lea Ypi. I flas shkurtimisht për të dhe me këtë rast me lejen e tij fiksojmë dhe një fotografi të rastit. Z Morris natyrshëm me shkopin e mblledhjes së mbeturinave në dorë dhe me qesen dhe unë me çantën time plotë me libra e programe të punës sime të përditshme, pa harruar dhe laptopin e peshën e tij në këtë ditë me diell, që në Londër kap 30 gradë celcius. Sidoqoftë biseda jonë mbetet e thjeshtë në këtë pikë, por me një shkundje të memrojes ime që më bën të kërkoj akoma më

tej në këtë tematikë.

Diku gjej atë që më intereson... Gjej pikërisht atë lidhje që gratë nikoqire dhe pastërtore në Shqipëri e bënin thuajse gjithnjë duke gëlqerosur shtëpitë dhe mbajtur pastër rrugët dhe hapësirat e tyre. Një risi e ngjashme vjen nga ky burim... Familja ime dikur jetonte në një rrugë me shtëpi me tarraca në veri të Anglisë, dhe nëna ime ishte shumë krenare. Ajo pastronte rregullisht edhe gurët që aksidentalisht ngacmonin pragun e hyrjes. Pos kësaj ajo vendoste një pllakë guri gëlqeror me madhësi sapuni dhe qëllimi i saj kryesor ishte të linte një vijë të pastër të bardhë në skajin e përpamë të shkallës. Shtëpitë në të dy anët e rrugës mund të dukeshin modeste nga jashtë, por nga brenda ishin si "pallate të vogla". Ishte një pamje mjaft e bukur të shikoje rrugës dhe të shihje të gjitha pragjet e hyrjes me skajet e tyre të bardha; secila duke treguar se banorët kujdeseshin shumë për "mbajtjen e pamjes".

Fakte dhe ngjashmëri të tilla ka mjaft. Edhe ajo që më lidhi me këtë arsye kërkimi, me faktin e z Morris natyrshëm është një shkas. Stephen Morris ka punuar një kohë të gjatë si shkencëtar i kompjuterit në City University në Londër. Dhe këtë përkushtim vullnetar tashmë e ka një detyrim ëprditësie që vjen nga koha kur ai e ndjente pastërtinë e shtëpive që pastroheshin nga të moshuarit dhe mjediset që shkëlqenin gjithnjë nga pastërtia. Tashmë ai vullnetarizmin e ka më shumë se një angazhim dhe ndjehet mirë.

MOTIT S'JEM PA GABRIELA MUJAJ PO DO SHIHEMI POETIKISHT

"Motit s'jem pa,

Plot trimijë

E shtatëqind vjet!

Asht krijue bot' e re"

Me atë varg disa ditë më parë këtë muaj, Gabriela Mujaj, la të gojëhapur sallën konkurruese në Borås të Suedisë, thjesht me një poezi që ndryshoi edhe mënyrën se si poezia u perceptua si një ngjarje publike dhe shtyu kufijtë e asaj që poezia mund të thoshte për lirinë e saj, për të vërtetën, për jetën, për prezencën dhe ekzistencën: atë që TS Eliot e quajti 'fjalë lirie që i thuheshin njeriut të lirë në publik'. Ky prezantim i poezisë "Ka mot s'jem pa" në Gegërisht, pati dhe një qasje të ndjeshme gjuhësore, pati dhe një duartëkëmbje të fortë ndjesore, që solli një krahasim, një shtjellë, një vlerë për një udhë të bukur poetike. Një krahasim midis të dyjave ofron një paraqitje të shkurtër se pse poezia bashkëkohore po shkon në dy anët dialektore sot dhe pse ajo flet njësoj sidoqoftë. E kështu kur "Gratë veshin pantallona,/ Ka burra që veshin funde/ Fëmijët mësojnë turra vrap/ Pleqtë marrohen shpejt/Koha e letrave ka ik" ka një tjetër udhë, ka një tjetër dimension poetik.

"Ka mot s'jem pa" është një poezi thellësisht personale në një nivel. Dedikuar fatit të sotëm të Njeriut, poetja nxjerr përvojën e përbashkët të ndjesisë mendore dhe efektit social, ndërsa në të njëjtën kohë e rrethon lexuesin me një ndjenjë dashurie marramendëse. Thuaj çfarë të duash, poetja na dëshmon, pavarësisht nga përvojat më

ndryshuese që jeta mund t'i ofrojë një njeriu, fryma e dashurisë mbijeton për të fisnikëruar jetën tonë nëse kemi zgjuars, guxim dhe besim - dhe art! - për të vazhduar.... Poetja Mulaj, nuk shmang asgjë, por e përjeton atë deri në fund. Ajo e përmban atë. E pretendon atë ndryshesë, atë mot që s'jem pa, si të vetën - dhe, ne besojmë, qesh me të dhe ka formë jete të shikoj një kënd të zgjedhur prej saj dhe ta regjistrojë atë dashuri në një poezi të punuar mirë, ku trenat janë modern/Nuk më frymzojnë me shkruar./U ba mot që s'jem pa,/Plot tri mijë e shtatëqind vjet /shkruar./Ç'ka s'ka ndodh qysh at'herë,/Por asgja e re/Pa marak./Kanë lind shumë fe,/Parti/Lidera/Shejten/Moda,/Por veç dashnia jet' e njajhtë".

Por nuk është as dashuria e njajhtë që nuk guxon të flasë më në fund emrin e saj, as katalogu i detajuar i tjetërsimit, që e bënë "Ka mot s'jem pa" himnin poetik të një brezi. "Ka mot s'jem pa" mund të quhet pa justifikim, një "sulm ndaj vlerave të pavlera" - dhe është ky sulm që mahnit dhe rezonon me gjeneratën e sotme kur harrohet se "Homeri ka shkruar Iliadën/Asht shkruar Shkrimi Shenjtë/Agustini Rrëfimet/Dante ka shkruar Komedi/Dostojevski Idjotin/Tolstoi Ana Kareninën/Hygoi Të Mjerët/Neruda Poezi/Pushkini Perlat e tij/Buzuku Mesharin/Bogdani Çetën./Martini Shpirtvargjet e Pavdekshme,At' Gjergji Lahutën e Patretshme." Pavarësisht nga situata thuajse e frikshme e "Ka mot s'jem pa" dhe kënaqësisë ndjesore që të jep poetja Gabriela Mujaj (një indulgjencë që ajo nuk e

kapërcen kurrë) në misticizmin dhe errësimin ezoterik, poezia është një tronditje cerebrale dhe emocionale e vetë kohës për sistemin. Ajo ia del mbanë në misionin e saj për të sulmuar sepse nuk është thjesht një shaka, por, siç thotë vetë, "E dhimshme deri n'bukuni/E bukur deri n'dhimtë."

"Ka mot s'jem pa" është e gjallë me ritëm, arsye dhe rrezik, që na fton për të punuar së bashku. Bën atë që shpreson se çdo poezi e mirë duhet të bëjë: troket paksa gjuhën, e kthen gjuhën me arsye të re dhe thotë diçka në atë mënyrë që të bën të heqësh kokën nga faqja dhe të mendosh përsëri për botën. Një dëshmi e fuqisë së "Ka mot s'jem pa" është se jeta dhe udha e Njeriut të lirë është ende duke u shtypur e poezia e saj me një gjuhë të rregulluar. E megjithatë, ky nocion se një poezi është gjuhë e rregulluar në një formë që ka fuqinë të flasë – të tronditë – përtej personit të afërt është nën sulm të rëndë dhe të vazhdueshëm në qarqet e poezisë bashkëkohore.

Për ironi, është poezia e

performancës ajo që po i ha karakteristikat universale të poezisë. Zëri është bërë, jo diçka që është ngjitur në rreshta të gjuhës në një faqe dikur boshe, por një gjë e fetishuar e pronës personale - zëri im, me theksin tim dhe gjithçka që kam për të thënë me këtë zë ka të bëjë me mua, mua... Unë. Kjo është arsyeja pse e vetmja mënyrë që mund ta përjetoni këtë gjuhë është nëse unë personalisht e kryej atë për ju. Por Mujaj thotë se të gjitha janë "gjana pa randësi.../E njajt asht:/Dashnia/ Dekal/Lindja/Dhimta/Andra." E pra ja pse poezia e Gabriela Mujaj që jeton dhe punon në Austri, "Ka mot qi s'jem pa" ngeci dhe në memorjen dhe seleksionimin tim në kohë, hapësirë dhe vend, pikërisht në 3 qershor 2023 në Boraås të Suedisë disa kilometra larg Vjenës dhe Londrës, pasi më ndihmoi shumë vargu "Aq sa ja kam harrue fytren vedit,/Plot trimijë e shtatëqind vjet!/Kurrë s'asht koha,/E koha asht gjithshka!" Eh, më ngacmove estetikisht, edhe pse motit s'jem pa Gabriela Mujaj, po do shihemi poetikisht.



AVDYL BUÇPAPAJ FLET DHE ME HESHTJEN E TIJ NJERËZORE



Shpesh herë Njeriu ndërton duke kërkuar padashje gravitetin e gjërave midis largësisë dhe afërsisë në një distancë disi ndryshe. Duke përshkruar atë distancë ndërmjet afërsisë dhe largësisë vetvetiu ndjen gravitetin në qendrën e një bisede, në qasjen e një njohjeje, në tërsinë e një komunikimi si njohje njerëzore. Ky funksion tërësor është si të ngresh blloqe betoni me zemrën e ndjeshme, të mallëngjyer e të emocionuar, dhe duke pyetur veten pse jemi deri tani në një panjohje? Përgjigjja është në formatin e saj e mbështjellë në kaos e lidhur në funksionin jetik, me atë që Njeriu takon njeriun vetëm

kur është mundësia, ose kur funksionon popullorja e urtë “Mali me mal nuk takohen, por Njeriu me Njeriun takohen”. Dhe takohen vërtet. Takohen ja pikërisht tek ky vend, që ka një emër të tjeshtë, e që bën mundësinë nga Njeriu i qetë e i denjë. Është ky vend me emrin Borås dhe është Njeriu Sokol Demaku që na prezanton me atë që pikërisht shemb të gjithë udhët drejt njohjes burrërore, të bardhë sikurse vetë bora e Alpeve. E ai është Avdyll Buçpapaj, një pinjoll i gjeneratës ndryshe të fisit të madh e emërmadh të atyre anëve. Dhe shtrëngojmë duart... Dua që dikush të më kuptojë si unë e kuptova këtë shtrëngim me Avdilin, ish drejtues shkollash në

vendlindje e në Durrës.

Tashmë Avdyll Buçpapaj, ish drejtor i shkollës “Demokracia”, tani drejtor i shkollës jopublike “Planetary” ka udhëtuar për të disatën herë në këtë qytet që na priti me diell. Ka qenë një nga protagonistët e një binjakëzimi me projektet e Demakut dhe kështu miqësia gjen formën e verës që sa më e vjetër të jetë dhe aq më e mirë bëhet.

Dhe mbahet mend ajo nisi bukur. Disa kohë më parë në kuadrin e realizimit të projektit madhor “Udha e shkronjave” përpiluar nga Fjärdingskolan e qytetit Borås në Suedi dhe shkollës fillore nëntvjeçare “Demokracia” nga qyteti Durrës, pra rreth shtatë vite më parë dhe realizuar me shumë sukses nga Sokol Demaku, mori rrugëtimin e tij edhe drejt Republikës së Kosovës konkretisht drejt qytetit verior Vushtri ku shtriu rrënjët edhe atje në shkollën fillore “Ali Kelmendi” të këtij qyteti. Asokohe pesë ditë me radhë ishin mysafirë të Fjärdingskolan në Borås, Kryetari i Komunës së Vushtrrisë Bajumarm Mulaku me drejtoreshën e shkollës “Ali Kelmendi” Kadrije Meniqi si dhe dy pedagogë nga kjo shkollë së bashku me përfaqësues të shkollës “Demokracia” Durrës me në krye ish-drejtorin e kësaj shkolle Avdyll Buçpapaj dhe dy pedagogët e cilat përfaqësuan këtë shkollë.

Dhe nga ato vite udhëtimi ka mbetur një gur i fortë në lidhjen miqësore dhe edukative të dy pikave dhe intelektualëve si Buçpapaj e Demaku. Asokohe Projekti

“Udha e shkronjave” mes shkollës “Demokracia” nga Durrësi dhe Fjärdingskolan nga Borås kishte qëllim të tijin zhvillimin e demokracisë në shkolla konkretisht zhvillimin e demokracisë tek nxënësit, respektin etnik dhe kulturorë në shkolla, por edhe i jepej një rëndësi e madhe edhe lëndës së matematikës. Avdyll Buçpapaj ish-drejtor në shkollën Demokracia më thotë tashmë se “dy shkollat si motra nga Shqipëria dhe Kosova me siguri kishin çfarë të mësojnë dhe marrin nga shkolla suedeze kur kishim të bëjmë me zhvillimin e demokracisë së shkollës si dhe integrimin e etnive në jetën e përditshme në shkollë por edhe në vendbanim dhe në ruajtjen dhe kultivimin e kulturës”.

Tashmë ky burrë i qetë dhe i dedikuar në projekte të përbashkëta me Sokol Demakun ndërsa gjerb kafënë. Emëngjesit në hotelin ku takohemi me një qasje ndryshe të pasqyron tërë atë brendësi intelektuale që tregon njerëzillëk, respekt dhe padyshim efikasitet në komunikim. E padyshim ndërsa komunikojmë në heshtjen tonë më duket se diku lexoj qartë dhe kuptueshëm atë që na bashkon në këtë rast me të ngjarë “Çlirohu nga gjykimet e ashpra... tani lidhu me njerëz si kurrë më parë”. E pra, aty në atë takim Njeriu ku tingëllon me njerëzoren kupton se dhe Avdyll Buçpapaj flet dhe me heshtjen e tij njerëzore.

EDHE NJË VLERË TJETËR E “BIG BOSS SERVICES” UK LTD

Kompania e mirrënjohur “Big Boss Services” UK Ltd, që drejtohet nga Gazmend Cufaj, në tërësinë e angazhimit të saj ka kohë që ka hedhur poshtë paragjykimin për veshjen dhe paraqitjen e punëtorëve të saj, duke i konsideruar se edhe ata kanë të drejtën e tyre estetike dhe kjo tregon respekt dhe profesionalizëm. Duke ditur se ekziston një keqkuptim i madh se punëtorët e ndërtimit janë të padukshëm, dhe se të gjithë presin që ata të jenë të ashpër dhe të ndotur, drejtuesi dhe stafi i kësaj kompanie mendojnë ndryshe. Prandaj ata kanë veshjet e përshtashme të punëtorëve me logon e kompanisë si shenjë dalluese, por dhe estetike të kësaj pike. Kjo është tashmë prej kohësh një realitet i “Big Boss Services” UK Ltd, dhe shumë larg së vërtetës që ndodh nga perceptimi i keq. Ekuipazhi i ndërtimit i “Big Boss Services” UK Ltd, përfaqëson markën e vetë dhe është fytyra e punës

cilësore në baza ditore. Gazmend Cufaj thekson, se “Pavarësisht nëse investitorët, klientët, ose inspektorët ndalen në vendin e punës, një ekip i veshur mirë i bën të ditur, se operacioni dhe përkushtimi profesional është me cilësi të lartë nga lart poshtë. Kur punëtori përgjegjës për fshirjen dhe mbajtjen e pastër të sitit vishet me të njëjtat veshje cilësore si menaxheri i projektit, kjo tregon se marka e kompanisë vlerëson çdo punonjës dhe kontributin e tyre në pamjen më të gjerë.” Përveç pamjes profesionale, veshjet e ekuipazhit të ndërtimit të kësaj kompanie janë funksionale dhe të sigurt. Këto veshje përballojnë motin e ashpër dhe punën e vështirë në natyrë, por dhe kohët me diell dhe me temperatura të larta. Ekipet e ndërtimit të “Big Boss Services” UK Ltd, kanë gjithashtu një sërë veshjesh, nga veshjet e shiut deri te veshjet e sipërme të ngrohta dhe këmbisha që marrin lirshmëri. Përmbushja

e nevojave uniforme të ekuipazhit të “Big Boss Services” UK Ltd, përfiton si punonjësit ashtu edhe siglën e respektuar të vetë kompanisë. Arsyetimi i shpenzimeve të uniformave të ekuipazhit të ndërtimit gjatë gjithë vitit me cilësi të lartë mund të jetë i ndërlikuar, kështu që drejtuesi i “Big Boss Services” UK Ltd, përkujdeset që ofrimi i veshjeve të punës të jetë edhe me cilësi të lartë, që është një prioritet, por gjithashtu përkujdeset që të ia vlejë çdo monedhë e shpenzuar. Ndaj drejtuesi i kësaj kompanie shton se “Kur e trajtoni ekuipazhin tuaj të ndërtimit si një ekip profesionistësh, ata do të jenë të gatshëm. Ekuipazhi juaj, si ekipet e tjera të punonjësve, pasqyron standardet e udhëheqjes së tyre. Kur i prezantoni ekuipazhin tuaj uniforma që pasqyrojnë cilësinë e lartë të udhëheqjes suaj, performanca e ekuipazhit do të shpërblehet me mirënjohjen dhe respektin e



tyre.” Parë në këtë kënd natyrshëm nënkuptojmë qartë humanizmin, profesionalizmin dhe përkushtimin me mish e me shpirt që gjërat, investimet, përkushtimet, avancimet e projekteve në këtë kompani të shkojnë mjaft mirë dhe bindshëm për rezultate të mira. Gjithashtu mirëkuptohet se personalizimi i veshjeve të punës është një mënyrë efektive për të krijuar identifikimin e ekipit që çon në një ekip të unifikuar. Ekuipazhi i tillë rrëfen qartë se është në vendin e punës me shumë nënkontraktorë të tjerë dhe ju dëshironi që stafi të duket më i miri, dhe më konkurrenti.

BIG BOSS SERVICES

(UK) LTD

BUILDING CONTRACTORS

big_boss_services_uk_ltd
 @BigBossServices
 BigBossServicesUkLtd

OUR SERVICES INCLUDE:

Guttering	PVC Windows	Plastering
Painting	Loft Conversion	Carpentry
Decorating	Extensions	Roofing
Power Clean	Kitchen Fitting	Brickwork
Scaffolding	Bathroom Fitting	Tiling



Tel: 020 8591 9198

Mobile: 07747 143 704 / 07883 029 474

Email: bigboss.services@yahoo.co.uk

website: www.bigboss-service.webs.com

UTR: 7168616298

CRN: 8344897

VAT NR: 215642524

Shesim apartamente në Durrës, Tiranë dhe në zonën e plazhit deri tek Mali i Robit

Kontakt: 07883029474 dhe 00355685309800

FESTIVALI I XII I POEZISË “SOFRA POETIKE BORÅS 2023”

1 20 poetë dhe dymbëdhjetë gjuhë të ndryshme u bashkuan me Antologjinë e Poezisë “Ord med vingar” (Fjalë me krahë) për të festuar Festivalin XII të Poezisë “Sofra Poetike Borås 2023”. Në këtë eveniment u bashkuan të gjitha shtresat e komunitetit të poezisë nga lexuesit të shkrimtarët, studentët të botuesit në një panel prezantimesh dhe diskutimesh, si dhe shfaqesh frymëzuese të udhëhequra nga poetët. Ishte një mundësi unike për të dëgjuar poetë të klasit botëror të diskutojnë talentin e tyre dhe të trajtojnë çështje kyçe, ndaj gjuha me të cilën folën thuajse ishte e kuptueshme, pasi ishte gjuha e poezisë që i bashkon dhe mirëkupton të gjithë me komunitetin botëror të poezisë! Poetë nga e gjithë bota morën pjesë në festivalin “Sofra poetike Borås 2023” i cili u zhvillua më 3 qershor 2023 nën përkujdesjen profesionale dhe mjaft të përkushtuar nga Qendra Kulturore Shqiptare “Migjeni”, që drejtohet nga poeti dhe publicisti i talentuar Sokol Demaku.

Dhe që në fillim me mbërritjen e të gjithë të ftuarve dhe atyre që vinin nga kënde të ndryshme të Borës krijuese, u bë ballafaqimi me pyetjen themelore të këtij eventi, cilat janë sfidat e drejtimit të një Festivali Poezie? Kjo pyetje që diskutohej në ambientet e qëndrimit dhe në kontaktet me poetë me emër në këtë Festival shtuan dhe të tjera si pyetjet: Cilat janë përfitimet për poetët, audiencën dhe botuesit? A kontribuojnë festivalet në ndjenjën e komunitetit? Çfarë lloj kërkimi mund të kontribuojë në suksesin e tyre? e mjaft të tjera, që hapën padyshim dhe siparin akademik të këtij eventi të bukur e mjaft domethënës. Ndërsa këto pyetje merrnin mesazhin kolektiv, bindjet se eventi kishte startuar para kohe ishin tashmë në një mjedis të gjerë e të

përkushtuar që niste me poetin Rizah Sheqiri në bashkëpunimin me Bahtir Latifin e poetet e tjera Anxhela Ziso, Gladiola Jorbus, që në fat si të zotët e shtëpisë u ndjenë mjaft miqësorë me të ftuarit.

Ndalesa tjetër, sala e madhe e evenimenteve kulturore! Menaxhuesi i eventit, Sokol Demaku kryeson këtë rast poetik emocionues të komunitetit botëror të poezisë në veprim. Do të bashkoheshin praktikisht



disa nga anëtarët e Lidhjes së Shkrimtarëve të Suedisë dhe mjaft të tjerë nga komunitete dhe shtete të tjera. E aty paraqitja kishte vlerën tjetër, modelin tjetër, qasjen disiplinore dhe avantazhin e paraqitjes deri në aktrim e madje edhe me forma nga më të larmishmet. Ky ishte shansi për të zbuluar një gamë emocionale të poezive suedeze, të konsiderohej se si të angazhohen komunitetet e marginalizuara dhe të mësohej më shumë rreth poezisë në përkthim. E gjitha ishte e qartë dhe e paqte me synimin e bukur e të domosdoshëm që të ndërtojmë një shoqëri ndërkombëtare poetësh!.

Nga forma dhe inercia estetike e Festivalit, që ndau dhe disa trofe dhe certifikata përbërja fine e poetëve e vazhdoi pasditen me një panel diskutimi që kremtoi kolektivët e poezisë për të

ushqyer breza poetësh që nga nisja e këtij Festivali, dhe që tashmë i bashkohet një risie të re e të bukur të ngjashme me atë që ata vetë e quajnë “Sofra Poetike”. Aty në fakt u eksploruan dhe vetë sfidat dhe sukseset e përbashkëta, se si kolektivët e poezisë kanë riformuar peizazhin aktual të poezisë dhe se si janë më të fortë së bashku. Më tej ky Festival me tërësinë e qasjes së tij trajtoi thelbin e duhur e të munguar në mjediset krijuese, se si

poezia mund të përfaqësojë dhe të arrijë komunitete më të ndryshme dhe me qëllimin që në të ardhmen të riformulojë perspektivat për poezinë dhe po atë dhe për aftësinë e kufizuar me synimin e përbashkët që përcaktoi Festivali se si mund ta bëjmë komunitetin e poezisë më gjithëpërfshirës.

Ndërsa dita e parë hidhte pas perden e tistë të natës, pasi nata vjen vonë, ose është e padukshme, të gjithë thuajse njëzëri shpreheshin se ne jemi të emocionuar që po punojmë me këtë eveniment poetik të krijuar mjeshtërisht nga Qendra Kulturore Shqiptare “Migjeni”, që drejtohet nga poeti dhe publicisti i talentuar Sokol Demaku. Në fakt Festivali i XII i Poezisë “Sofra Poetike Borås 2023” solli në mjedisin e tij të bërë traditë tashmë dhe dy poetë dy poetë të vlerësuar me Çmimin “Penad e Artë”, i

cili do të mbyllte ditën e parë të festivalit. Britta Stenberg përjetoj emocione gjatë marrjes së këtij çmimi, ku në anën tjetër poeti Fatmir Terziu, natyrshëm u ndje mes vetë emocioneve të ndjeshme. Koleksionet debutuese, natyrshëm meritonin më tej një numër çmimesh të tjera që u pritën me duartrokitje. E kështu Festivali i XII i Poezisë “Sofra Poetike Borås 2023” vazhdon të tërheqë talentet e poetëve në të gjithë Mbretërinë e Suedisë dhe ndërkombëtarisht, duke shfaqur shkrimin dhe botimin verior në këtë Antologji, të cilën e cituam më lart.

Tema pos qasjeve dhe emetimit të poezive në këtë eveniment mjaft domethënës të 2023-istit ishte në thelb “Komuniteti”. Demaku i pyetur për këtë theksoi se “Nën këtë temë, ne eksplorojmë kontributin e poezisë në komunitete të ndryshme dhe fuqinë e kolektiveve të shkrimit për të inkurajuar krijimtarinë.”

Bahtir Latifi bëri mesazhin që natyrshëm kishte përkuar dhe me thirrjen “Bashkohuni “Sofra Poetike Borås 2023” që zhvillohet së bashku me Shoqërinë e mirënjohur “Migjeni”. Kështu tematika festive e cilësuar me të drejtë komuniteti udhëtoi në ditën e dytë mes ngjyrave, melodive, këngëve dhe vallve, rrobave karakteristike shqiptare dhe suedeze në parkun e gjerë dhe të gjelbër Ramnaparken të qytetit Borås. Me rrobat shqiptare vjen dhe emri i të talentuarës dhe të përkushtuarës Emine Hoti, që kishte udhëtuar nga Norvegjia për këtë eveniment. E kështu komuniteti bashkoi poetë dhe komunitete në këtë park mjaft të bukur e tërheqës. Një duzinë ndërtesash të bukura dhe pjesërisht mjaft të mëdha historike nga komuna Borås Kommun mund të admirohen në muzeun e hapur të Muzeut Borås në periferi të qytetit qendror Borås.

MES KOLORITIT DHE TRADITËS: TË NDRYSHËM POR SA TË NGJASHËM

Ngryrat dhe ajo që vjen nga gjuha e tyre ishin diskursi i vërtetë i një pike kulturore që bashkon dhe unifikon mes gjuhës dhe vetë diskursit kultural një nismë që flet me shumë kuptime. Dhe kur ngryrat e kostumeve tradicionale vijnë jo thjesht me gjuhën e tyre, por me performancën artistike, me gjuhën e vetë komunikimit dhe shpjegimit të përjasjes, më së shumti pikëtakojnë atë që sot mungon dhe atë që sot synohet të mbetet një vlerë në ripërtëritje. Është natyrshëm Sokol Demaku, që veç të tjerave ka bërë të mbetet një model tërësor, pra edhe vetë “njeriu kamera”, duke udhëtuar kështu mes memorjes sime në pikëtakimin eme studimin tim me britanikun Paul Watson, ose të ashtuquajturin “One man Camera” pasi ai ashtu vetëm ka bërë mrekulli realizimi duke përdorur vetë, dhe vetëm ai, kameran e tij. Ndërsa Paul Watson u quajt i tillë se realizoi disa domukemantarë televizivë për BBC dhe Channel Four në Mbretëri të Bashkuar, i palodhuri tipologjik, Sokol Demaku, duke qenë vetë ideator, kameran, realizues dhe artist, realizon disa fiksime në kameran e tij, që natyrshëm e bëjnë atë “One man Camera” me stilin shqiptar në Borås të Suedisë. Ndërsa Paul Watson ishte britanik dhe realizonte duke përdorur kameran e tij të vetme dokumentarë e tij në çështje sociale, realizuesi shqiptar, Sokoli i gjithëanshëm, mësues matematike, mësues në shkollat suedeze, drejtues i shoqatës “Migjeni”, poet, shkrimtar, dhe kështu dhe dokumetarist, realizon më 4 qershor 2023 në takimin mes kulturave të ndryshme, asaj shqiptare dhe suedeze, dokumentarin me mjaft kolorit dhe tejet diskursiv, “Të ndryshëm por sa të

ngjashëm”. Dhe kjo ndodhi në Ramnapark, në një lartësi, që natyrshëm tashmë mbetet një nga parqet më të mëdha të Borås, që nga fillimi i shekullit të 20-të. Ky park që ndodhet në perëndim të qendrës së qytetit priti në këtë datë dhe fiksoi në kameran e Sokolit atë që natyrshëm sytë e panë, veshët e dëgjuan dhe memorja do ta mabajë gjatë. Këndet e lojërave dhe shtigjet e ecjes që gjenden rreth gërmadhave të pyllëzuara përreth me pllaja të hapura u bënë pjesë me atë që Demaku fiksoi në memorjen kolektive. Në këtë memorje natyrshëm rol të madh kishin kostumet e të anëve.

Në këtë pikë nga pala suedeze dukej se kishte më shumë respekt në rrëfim, në sqarim dhe në prezantim, gjë që foli dhe flet shumë. Dhe ata me anën e një konferencereje mjaft oratore shpjeguan në atë park, në atë eveniment të qasjes tradicionale të kostumeve, se në Suedi ka rreth 840 kostume popullore suedeze, duke përfshirë edhe ato sami. Rreth 550 prej tyre janë kostume grash dhe rreth 290 kostume burrash. Kostumet popullore suedeze janë fillimisht veshje historike e popullit të thjeshtë suedez që vishej dhe ndryshonte gjatë gjithë vitit përpara revolucionit industrial. Detajet e disa kostumeve suedeze duhet të ndryshojnë sipas festave të kishës sipas almanakut të kostumeve të rajonit. Pasi komuniteti fshatar filloi të vishte në një masë më të vogël kostumin kombëtar, veshja nga fundi i viteve 1800 u vu re nga shoqëria dhe filloi të përdoret në kontekste festive si veshje ceremoniale. Aty u tha dhe u sqarua se në një kuptim më të gjerë, kostumet popullore përfshijnë edhe kostumet e fshatit, ose kostumet e famullisë që janë krijuar dhe kompozuar më vonë me frymëzim nga

kostumet popullore dhe kanë marrë emrin e një fshati ose famullie. Në vitet 1960, kostumi popullor pati një rilindje tjetër dhe që atëherë shfaqet sërish si kostum feste dhe festive. Veshja e vendit përdoret si sinonim për përkufizimin më të gjerë të kostumit popullor. Historikisht, asnjë kostum nuk ka përfaqësuar një peizazh të tërë, por në lidhje me ngritjen e lëvizjes së atdheut në fillim të shekullit të 20-të, u bënë përpjekje për të krijuar kostume popullore për të gjitha pjesët e ndryshme të Suedisë. Ata zakonisht zgjidhnin rajone ku nuk ruhej asnjë, dhe i rikrijonin ato në bazë të peizazheve, dhe gjithashtu lejonin që disa veshje të ruajtura nga një pjesë e peizazhit ta përfaqësonin atë në tërësi. Ndërsa nga organizatorët u tha se kjo ishte një nismë që kishte për qëllim bashkimin e kulturave, në thelb ajo ishte një karakteristikë mjaft e madhe dhe e gjerë për të mësuar edhe në kënde të ndryshme, këngë të paraqitura nga të dy palët, ushqimet, vallzimet, prezantimet, bisedat, interpretimet kulturore, paradat, shërbimi, disiplina, kultura, vlerat, brezat, të rinjtë dhe të rejtat, dhe moshuarit, vendasit dhe të ardhurit natyrshëm kishin një shtysë më shumë në këtë diskurs koloritësh, ritesh, traditash

dhe efektsh trashëguesë. Udhëtimi kulturor në mjedisin arbëresh me vallet e paraqitura, veshjet dhe me duart fisnike mjeshtërore të qasjeve komëbatre nga Emine S. Hoti, që shquhet për veshjet e kombinuara me karakter modern kombëtar, natyrshëm ishte koloriti më i bukur dhe më i ndjeshëm. Përtej këtij fisnikërimi nga duart e mjeshtres Emone S. Hoti në lidhje me kostumet tradicionale shqiptare, në këtë mjedis ndoqa dhe pashtë dhe efektin vendas me jelekë dhe mantel elegant nga Sjuhärad, të cilat vinin prej Muzeut të Tekstileve që i përkasin kostumeve popullore në Sjuhärad, një zonë rreth Borås. Kjo qasje dukej se plotësohej edhe me dy kostume të plota nga Toarp, të cilat ishin rikonstruktuar nga ekspertët vendas të kostumeve. Për të interesuarit për kulturën popullore dhe artizanatin, qasja e tillë kulturore ofronte shumë frymëzim. Shumë prej pëlhurave ishin të endura në shtëpi dhe rrobat ishin të qepura me dorë, sikurse bën dhe vazhdon të bëjë Emineja shqiptare me kostumet tradicionale që i përqas sipas kohës, vendit dhe hapësirës. Ishte një punë që kërkonte kohë që kërkonte mjeshtëri të madhe në të dy anët, por rezultati ishte mjaft efikas, mjaft pozitiv.



PRURJE E RE TIPOLOGJIKE E ASTRIT LULUSHIT



Astrit Lulushi me librin e tij të ri “Realitet dhe vetëdije” (2023) të botuar nga “Tirana Times” e Jerina Zaloshnjës ka prekur në rreth tetëdhjetë stacionime të vogla rrënjësore teorike, thelbin e asaj që përshkajnë tre fushat e filozofisë. Kështu ky libër me gjetjet dhe shpjegimet e autorit hyn dhe zhbiron nga: Teoria e Realitetit: Ontologjia dhe Metafizika; Teoria e Dijes: Epistemologjia; Teoria e vlerës: Aksiologjia. “Realitet dhe vetëdije” kërkon më tej dhe sjell për lexuesin mjaft arsye që shkojnë dhe pikëtojnë substancat kundrejt procesit, ku natyrshëm aspektet e filozofisë së shkrimit përgjigjen hera-herës nëse të gjitha këto janë gjërat themelore, pra substanca të përmbajtura në vetvete, të vetë-mjaftueshme dhe të përjetshme, apo po ndryshojnë procese, të ndërvarura nga njëri-tjetri. Duke ditur se filozofia e substancave rreket dominuese në tërësinë gjeografike, autori mes prurjeve të tij sjell mjaft shembuj të substancave, ku lexuesi kupton atë që sillet dhe sqarohet tek Zoti: i përjetshëm dhe i pandryshueshëm, tek shpirtrat: të përjetshëm dhe të pandryshueshëm, apo dhe me atomet: nuk krijohen dhe nuk mund të shkatërrohen. Edhe pse autori nuk merr në konsideratë procesin dhe filozofët e procesit në shkrimet e tij mjaft herë të publikuara tek Fjala e Lirë në Londër dhe në disa raste dhe në këtë libër e në disa nga librat e shumtë të tij, na afron mundësinë të shijojmë gjeografikisht

Filozofët e procesit, të cilët nga Evropa dhe Amerika janë: Heraklitus, Hegel, Bergson, Whitehead dhe Hartshorne, nga hapësira Aziatike: Budizmi, Daoizmi dhe Konfucianizmi dhe pjesa tjetër Abrahamike kundër feve aziatike.

Në tërësinë substanciale të “Realitet dhe vetëdije” ka në thelb nëntekste që shkojnë tek pyetje të ndyshme të realitetit “organik” apo “atomist”. Dhe kështu duke lexuar shprehim intuitën tonë të perceptimit, klasifikimit, mendimit në siluetën e pyetjes a kishin të drejtë të lashtë të shihnin shoqërinë dhe realitetin si një trup të gjallë, apo kishin të drejtë filozofët modernë kur menduan se ne jemi më shumë si atome “sociale” që kërcejnë në hapësirën boshe të shoqërisë, e cila në tërësinë e shkrimeve shkon më tej e më tej, derisa në shtysën për ta lexuar sërrish këtë autor mjaft studiues, të përkushtuar në këndin e vetë personal, por dhe me një shije përzgjedhëse. Autori në këtë libër na sjell në mënyrë efikase edhe një pikë tjetër të rëndësishme filozofike që mbështetet tek pikëpamjet hierarkike kundër egalitare të shoqërisë, sikurse ndodh tek “Baza” (fq.22) apo edhe “Ndërgjegje” (fq. 132).

Duke vazhduar tek “Ndërgjegje” Lulushi sjell në vëmendje “Në të shkuarën besohej se realiteti fizik që përjetojmë ekziston i pavarur nga vëzhgimet tona. Me fjalë të tjera, ekziston një realitet material aktual.” Pra që në gjuhën filozofike nënkupton thelbin e problemit mendje-trup. Në këtë thelb, apo problem hyjnë: Materializmi, që ka vetëm materie dhe mendja nuk është gjë tjetër veçse qelizat e trurit që ndezin. Po ashtu hyn dhe zberthehet edhe Dualizmi,

që ka substancë mendore përveç substancës materiale. Në këtë mënyrë e në shkrime të tjera të “Realitet dhe vetëdije” ndiejmë Idealizëm/Mentalizëm/Spiritualizëm, pra ato që natyra themelore e realitetit i konsideron se janë mendja, ose shpirti. Ndërsa dihet se materia është derivat, ose iluzion, autori tek “Ndërgjegje” na sjell efektin e thelbit që sqaron “Vetëdija është misteri i mistereve. Është e vetmja gjë e njohur drejtpërdrejt për ne. “Nuk ka asgjë aq të paimagjinueshme se sa materia e vetëdijshme për veten e saj” (Blaize Paskal).

“Realitet dhe vetëdije” në tërësinë e tetëdhjetë kapjeve ndalet shkitazi edhe tek monizmi neutral, ku vetë natyra themelore e realitetit nuk është as mendja as materia, ndoshta energjia, duke na tejçuar më pas tek natyra njerëzore. Esetë dhe temat e tij “I qenësisshëm”; “Ku u varros Aleksandri i Madh”; “Natyra dhe ne”; etj., na japin ide dhe njohuri në këtë qasje, por dhe na arsyetojnë me shumë guxim udhën për të mësuar se cila është marrëdhënia midis arsyes, vullnetit, emocioneve dhe imagjinatës. Me këtë rast në disa pika ky libër është një çelës për të hyrë në arkivën e madhe të leximeve të shumta që me dijet dhe shijet e veta autori i ka racionuar dhe stacionuar të bëhen të lehta e të lexueshme.

“Realitet dhe vetëdije” i autorit Astrit Lulushi edhe pse i njohur në ëprditshmëri tek “Fjala e Lirë” në Londër, në atë që duhet theksuar për lexuesin tashmë me grumbullimin në libër të të gjitha shkrimeve të tij, mundëson më gjerë të kuptohet se a janë njerëzit në thelb të mirë, të këqij, kombinim i të dyjave, apo asnjëra, a është vullneti i lirë, apo përcaktohet nga shkaqet dhe kushtet pararendëse (determinizmi), apo edhe a është shpirti i pavdekshëm? A ka një jetë e përtejme, apo kjo jetë është gjithçka që ekziston. “Realitet dhe vetëdije” është

një kënd tek vetë ajo që quhet Teoria e Dijes, ku lexuesit, të interesuarit, autorë, kërkues, studentë, pedagogë e të tjerë rreket tek rrethotullimi jetik se si dhe çfarë mund të dimë. Në këtë pikë hyn natyrshëm vetë racionalizmi, të cilin me mjeshtëri e bën të ndjeshëm e të qartë Astrit, duke na ritreguar shkurt, saktë dhe bukur se njohuria e vërtetë tashmë ekziston në shpirtin e njeriut si njohuri “e lindur”. Platoni mban qëndrimin më radikal për këtë çështje, por Aristoteli qëndron si një kompromis midis racionalizmit dhe empirizmit. Sakaq empirizmi, pra njohuria vjen kryesisht nga përvoja dhe pesë shqisat nuk mund të lihet më njanë pa u ndeshur tek “Realitet dhe vetëdije”. Ne mund të shtojmë mjaft emra, por ndalemi tek Epicurus, John Locke dhe David Hume. Locke besonte se mendjet tona janë si “tableta bosh” dhe përvoja “shkruan” në mendjen tonë, ashtu siç shkruajmë në një dërrasë të zezë. Për të nuk ka njohuri të lindura.

Do të shtoja para se ta përfundojë këtë ndalesë tek “Realitet dhe vetëdije”, libër tek i cili kam shkruar dhe Parathënien, edhe disa segmente tek vetë Teoria e Vlerës, që spontanisht dhe jo pak herë ceket nga Lulushi. Në këtë pikë janë Etika, që ricakton vlera për individin “Çfarë duhet të bëj si individ?”, është Filozofia Sociale dhe Politike, pra vlera për shoqërinë, ose më saktë “Çfarë duhet të bëjmë së bashku?” dhe së fundi Filozofia e Artit dhe Estetika, saktësisht vlera në artet e bukura dhe bukuria natyrore. Të gjitha këto e mjaft të tjera e bëjnë “Realitet dhe vetëdije” një prurje të re, të munguar, të sistemuar, logjike dhe të domosdoshme. “Realitet dhe vetëdije” dhe autori i saj, që tashmë ka dhe “Kalendarin Historik” në duart e lexuesit, natyrshëm kanë bërë detyrën e tyre humane, por ajo që shkon më tej është nxitja të lexohet dhe të mirëkuptohet në thelb mundi.

Ndihma jonë

Dedikim
Respekt



MAHMUD ŞIRINGÜL



Thank
you!

ALBANIAN POST



RESPEKTI I
GJITHË
SHQIPTARËVE

KJO REKLAMË SHKON NË NDIHMË TË TË
DËMTUARVE NGA TËRMETI

RESPEKT

DAILY FRESH HALAL MEAT AND FRUIT



HILAL FOOD CENTRE

International Food Centre

318-324 Kilburn High Road,
London, NW6 2QN
020 7372 1059

VEAL
SPECIAL
OFFER

